

ISLAMI KARSHI DHUNËS



Dhuna nuk është natyrë e Islamit, ndërkaq të shumtë janë atë që përpiqen t'i paraqesin muslimanët si të dhunshëm. Ky perceptim është padyshim i gabuar dhe i padrejtë. Allahu në Kuran është i cilësuar më shumë me atributet e mëshirës, faljes, butësisë dhe bamirësisë. Vetëm emrat **Rahman** (i Gjithëmëshirshmi) dhe **Rahim** (Mëshirëploti) së bashku janë përmendur 118 herë, e lëre më emrat e tjerë. Në Kuran mëshira paraqitet e përgjithshme, për dallim me dënimin që paraqitet si i kushtëzuar. Allahu thotë: **“Unë godas me dënimin Tim kë të dua, ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë.”** Zoti na e bëri të qartë në shpalljen e Tij të fundit se misioni dhe përmbajtja e mësimave të Profetit Muhamed është ‘mëshirë për botët’ dhe në këtë kuptim ai proklamoi se: **“Ai që nuk mëshiron (të tjerët) nuk mëshirohet (nga Allahu).”** Aktet e dhunshme të kryera nga muslimanët viteve të fundit si: rrëmbimi i avionëve, marrja e pengjeve, vrasja e turistëve, vendosja e bombave në qendra tregtare dhe vende publike duke vrarë civilë, e akte të tjera të ngjashme si këto Islami i dënon pavarësisht përkatësisë së kryerësit. Feja jonë ka qëndrim kategorik ndaj terrorizmit, sepse në asnjë mënyrë nuk lejohet agresioni ndaj njerëzve të pafajshëm. Rregulli parësor që ka vendosur Kurani dhe të gjitha librat e shpallur është: **“Se askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit.”** Dhuna nuk është fenomen vetëm të muslimanët, por edhe te të gjitha besimet dhe kombet, prandaj duhet të angazhohen të gjithë pa përjashtim për ta denoncuar atë. Grupimet islame që kanë zgjedhur dhunën si mjet, e kanë bërë këtë në sja të frymës ideologjike që mbartin. Të tillë ishin edhe paraardhësit e tyre **havarixhët**, të cilët ishin të përkushtuar në kryerjen e disa adhurimeve fizike, mirëpo në anën tjetër lejonin pa të drejtë derdhjen e gjakut të muslimanëve dhe të tjerëve. Pra, defekti i tyre qëndron te logjika dhe niveli i të kuptuarit të tyre për fenë, njerëzit dhe jetën në përgjithësi. Nga këtu ne konsiderojmë, se ballafaqimi i parë me ta duhet të bëhet në rrafshin ideologjik, pikërisht ashtu si veproi **kalifi i drejtë** Aliu para 14 shekujve, kur dërgoi Ibën Abasin për të polemizuar me ta dhe pas një debati të nxehtë e të gjatë rezultoi që hoqën dorë nga konceptet e gabuara mijëra prej tyre. Nisur nga ky fakt është detyrim i dijetarëve dhe i hoxhallarëve, që të debatojnë më të gjithë ata që kanë interpretime specifike të fesë dhe që i përdorin citimet në vende të gabuara, në mënyrë që t'ua ndryshojnë ato koncepte dhe t'i orientojnë në kuptimin e drejtë të Islamit. Ata janë kryesisht njerëz me nivel mesatar, të cilët nuk e kanë kurajën të zhyten në thellësi të objektivave të argumenteve, megjithëse lexojnë Kuranin, por mësimet e tij nuk ua tejkalojnë fytnin e tyre për t'u depërtuar në zemër. Faza e parë e ballafaqimit të dijetarëve duhet të jetë në logjikën e veprimeve të tyre. Sa janë me të vërtetë legjitime ato dhe: a kanë bazë në mësimet e fesë? Cilat janë të arritjet nga veprimet e dhunshme? Çfarë ndryshimi pozitiv kanë arritur të bëjnë? Çfarë përfitimi arriti umeti islam nga operacione të tilla? Rezultati i këtyre aksioneve është se shumica e viktimave që ata kanë shkaktuar janë muslimanë dhe njerëz të pafajshëm, ndërsa Allahu thotë: **“Kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri, ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin.”** Kryerësit e tyre, ose janë vrarë, ose dergjen nëpër burgje. Veprime të tilla në masë të madhe kanë ndikuar në ndalimin dhe pengimin e veprimtarisë së thirrjes islame, si në botën arabe edhe më gjerë, mbylljen e shumë shoqatave kulturore dhe humanitare nga të cilat kanë përfituar miliona njerëz dhe më e keqja prej të gjithave, ata kanë njollosur imazhin e Islamit dhe muslimanëve anekënd botës. Ajo çfarë me të vërtetë është për t'u përshëndetur kohët e fundit dhe që përbën edhe një përgëzim dhe shpresë është pendimi i hapur për veprimet e dhunshme, që kanë bërë në të kaluarën i shumë grupimeve dhe protagonistëve. Ata e kanë pranuar fajin dhe i kanë kërkuar falje publikut, dhe të gjithë atyre që u kanë shkaktuar dëm. Pra, dhuna që shkaktojnë pjesëtarët e besimit islam duhet të luftohet me të gjitha format dhe mjetet së pari nga vetë muslimanët.

në emër të redaksisë: Agron TERZIQI

AKTUALE

- 3-5** | “SHKUPI ËSHTË MEKA E BALLKANIT”
- 6-8** | REGJISTRIMI I POPULLSISË APO HAPJA E KUTISË SË PANDORËS
- 8-10** | BLIC LAJME

DRITARE

- 11-14** | DHUNA DHE RIKTHIMI I TË RINJVE NË FE
- 14-18** | POPULLI I ZGJEDHUR I ZOTIT?!
- 19-20** | HOXHALLARË SHQIPTARË, QË DEKLAROHEN KUNDRA TERRORIZMIT

AKIDE

- 21-25** | TË SHPIFËSH PËR TË PAQENËN?!

FIKH

- 26-29** | DAJAK APO EDUKIM PËR GRUAN?!

FAMILJA

- 30-32** | RRINI LARG NESH, O NJERËZ TË DHUNËS
- 33-34** | O PRINDËR, KU I KENI KËTO CILËSI?!

SFIDA

- 35-38** | LIRIA NUK ËSHTË DEMOKRACIA

EKONOMI

- 39-42** | VEPRIMTARIA E BANKAVE ISLAME

AVANCIMI PERSONAL

- 43-45** | PIKA KULMORE E DOBËSISË

TEFSIR

- 46-48** | “JU KENI FENË TUAJ, E UNË KAM FENË TIME!”

HADITH

- 49-52** | BUTËSIA ËSHTË DETYRIM FETAR DHE FSHEHTËSI PËR ARRITJE

THESARE

- 53-54** | SHKENCËTARËT E HUTUAR

FETVA DHE KONSULTIME

- 55-57** | KUSH E DO NJERËZIMIN MË SHUMË SE ISLAMI?!

BOTA ISLAMEE

- 58-60** | INDONEZIA, VENDI ME MË SHUMË MUSLIMANË

REDAKSIA

*Kryeredaktor: Omer BERISHA
zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI
Anëtarë të redaksisë:*

Ismail BARDHOSHI, Bekir HALIMI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI, Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Redaktor teknik: Halil BERISHA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Shpërndarje dhe marketing: Sedat RAMADANI

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOËL

Xhironlogaria: 30000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

“SHKUPI ËSHTË MEKA E BALLKANIT”

Shpirtrat e zbrazur nga dashuria, besimi, madhështia, shpresa, frika, mbështetja dhe nënshtrimi ndaj Zotit mundohen ta mbushin atë zbrazëti me idhuj, buste e kotësi të tjera, siç jemi dëshmitarë të asaj që po ndodh ditëve të fundit në Shkup nga ana e qeverisë së arrogantisë së Nikolla Gruevskit

SHKRUAN: OMER BERISHA

Kohëve të fundit, si në shumë vende të tjera, edhe në trojet tona njerëzit kanë filluar të kuptojnë nevojën e domosdoshme për ta ushqyer shpirtin paralel me trupin. Kjo m’i shton shpresat se e mira është ardhmëria e këtij populli, sepse kuptimi i kësaj në formën e saktë do të rezultojë në aktivitetin, mundin dhe dëshirën e flaktë për të fituar mirëqenien shpirtërore dhe trupore. Mirëpo normalisht çdo synim ka mënyrat dhe rrugët e caktuara për t’i mbërritur ato dhe nëse njeriu nuk i mëson ato nuk i mbërrin dot. Në këtë gjë me siguri pajtohet kushdo që gëzon dhuntinë e madhe nga Allahu, logjikën.



Mirëmbajtja e trupit dhe e shpirtit realizohet me porosinë dhe mësimet që i jep Krijuesi i tyre, përndryshe nëse i kthejmë shpinën atyre mësimëve apo i përziejmë atëherë do të përballemi me anomali nga më të ndryshmet dhe më të çuditshmet.

Shpirtrat e zbrazur nga dashuria, besimi, madhështia, shpresa, frika, mbështetja dhe nënshtrimi ndaj Zotit mundohen ta mbushin atë zbrazëti me idhuj, buste e kotësi të tjera, siç jemi dëshmitarë të asaj që po ndodh ditëve të fundit në Shkup nga ana e qeverisë së arrogantit **Nikolla Gruevskit**. Në thelb, këto veprime nuk janë të çuditshme kur burojnë nga një njeri që i përket një feje ku idhujt dhe ikonat adhurohen më shumë, sesa Krijuesi i gjithësisë.

Mua më habit dhe më çudit dëshira për të imituar një njeri si Gruevski nga ana e disa shqiptarëve, të cilët njihen se i përkasin kësaj Feje, e cila erdhi për t'i garantuar gjithë njerëzimit Fenë e drejtë, jetën, familjen, pasurinë dhe logjikën. Por me sa duket nga kjo përkatësi ata nuk kanë fituar asgjë përpos emrit dhe votave të shqiptarëve muslimanë. Imitimi ditëve të fundit u manifestua me kërkesat dhe planet e disa partive politike dhe OJQ-ve për të ngritur buste dhe përmendore të heronjve dhe figurave të shquara shqiptare nëpër sheshe të ndryshme përveç atij të Qendrës së Shkupit dhe në këtë mënyrë do t'i jepkan hakun detyrës së marrë dhe do të mbaruakan problemet e popullit tonë, ndërsa po harrojnë se problemet e popullit tonë ende janë shumë të thjeshta: varfëria, pasiguria, humbja e të drejtës për t'u arsimuar etj.

“...I mençuri mëson nga gabimet e të tjerëve, kurse budallai nga gabimet e veta...”

Që të gjithë ata, së bashku me Gruevskin dyshoj se do të vetëdijesohen një ditë për prapambetjen që po instalojnë në këtë gjeneratë. Gjer më tani kemi qenë dëshmitarë, se bustet e vendosura nëpër vende të ndryshme nuk paraqitnin për shumicën e njerëzve ndonjë vlerë të veçantë, me përjashtim të atyre që dëshironin të përfitojnë materialisht prej tyre, jo duke i lutur, jo duke ndezur qirinj e as duke u bërë homazh, por duke shitur materialin me të cilin ishin ndërtuar. Për mua ky veprim i njerëzve nuk ishte i gabuar, sepse të gjallët janë më meritore t'i gëzojnë të mirat e kësaj bote, sesa ata që u shpërngulën për në botën tjetër. Të vdekurit, nëse kanë besuar drejt dhe kanë bërë vepra të mira do t'i gjejnë ato, përndryshe Allahu e di se si do të veprojë me ta. Ky është besimi i muslimanëve, të cilët gjithashtu lutën që dëshmorët dhe njerëzit e mirë t'i fitojnë shpërblimet më të mëdha tek Allahu. Kurse në këtë botë ata mundohen të ndjekin gjurmët dhe mësimet e tyre, duke folur e shkruar për ta dhe duke i bërë shëmbëlltyrë në jetë, por assesi duke i pikturuar dhe duke ngritur buste për ta.

I mençuri mëson nga gabimet e të tjerëve, kurse budallai nga gabimet e veta. A e dini sesi u shkua deri tek adhurimi i idhujve në të kaluarën dhe shndërrimi i tyre në zota përpos Krijuesit? Pasi ndërroi jetë Ademi, alejhi selam, mbetën bijtë e tij

në fenë e babait (fenë islame) dhjetë shekuj me radhë e pastaj mohuan. Shkaku i mohimit ishte teprimi me dashurinë ndaj njerëzve të mirë. Allahu na tregon: *“...ata thanë: Mos i braktisni të adhuruarit tuaj, mos e braktisni Vedin, Suvanë, Jeguthin, Jeukun dhe Nesrin”*. Këta pesë persona kishin qenë njerëz të mirë, që përhapnin të mirën dhe qortonin të keqen, por që të pestë vdiqën brenda një muaji. Atëherë njerëzit u frikësuan se Feja do të dobësohet dhe formësuan (me pikturë a skulpturë) pamjen e secilit prej tyre në shtëpitë ku më parë kishin jetuar këta persona, me qëllim që kur t’i vizitojnë dhe t’i shohin, të përkujtojnë fjalët dhe veprat e atyre njerëzve të mirë, por nuk i adhuronin. As përkuleshin para tyre, as nuk u bënë homazh. Pastaj erdhi gjenerata e re dhe tregoi një respekt edhe më të madh ndaj atyre pikturave dhe skulpturave, por edhe këta nuk i adhuronin. Mirëpo, pas një kohe të gjatë kur dijetarët u pakësuan, shejtani i bindi se ato figura kanë aftësinë që të ndërmjetësojnë tek Zoti dhe tashmë filluan t’i adhurojnë. Kur ndodhi kjo, atëherë Allahu dërgoi Nuhun, alejhi selam, që t’i kthejë njerëzit në besimin e drejtë...


Pas çdo pejgamberi paraqitej ndonjë bashkëpunëtor i djallit dhe si një ndër metodat më të lehta për t’i larguar njerëzit nga logjika e shëndoshë dhe besimi i drejtë gjetën ngritjen dhe formësimin e figurave të njerëzve të mirë, sepse kjo përfundonte me adhurimin e tyre gjithsesi. Kështu veproi edhe Amër ibën Luhaji, i cili nga Shami i atëhershëm kishte sjellë puta, të cilat i vendosi pranë

“...Pas çdo pejgamberi paraqitej ndonjë bashkëpunëtor i djallit dhe si një ndër metodat më të lehta për t’i larguar njerëzit nga logjika e shëndoshë dhe besimi i drejtë gjetën ngritjen dhe formësimin e figurave të njerëzve ... ”

Qabesë në Mekë dhe kur instaloi këtë “vlerë” ajo dita-ditës përhapej dhe numri i idhujve të ndërtuar u shtua derisa arriti numrin 360. Por në ditën kur te banorët e Mekës erdhi drita e besimit dhe e kuptuan se shenjtërimi dhe adhurimi i gurëve e drunjve është humbje e xhenetit, dhe nënçmim i logjikës nuk lejuan të mbetet asnjë put tek ai popull tashmë i ngritur dhe krenar dhe i thyen që të gjithë.

Sot, po projektojnë që Shkupin ta mbushin me idhuj, puta e buste, ndërsa pengojnë xhamitë, vende ku adhurohet Allahu, Krijuesi i gjithësisë dhe Dhuruesi i mirësive të panumërta. Unë shpresoj që asgjë nga ato projekte famëkeqe të realizohet. Sido që të ndodhë, është thënë se “Shkupi është Meka e Ballkanit”, nëse mbushet me puta, shpresoj të vijë dita kur do të thyhen që të gjithë. ■

Tashmë kutia e Pandorës është hapur, rrethanat historike kanë ndryshuar krejtësisht dhe shqiptarët nuk mund të fshihen pas gishtit. Le të kujtojmë një thënie të rilindësit Faik Konica, që "Shqiptarët po të kishin ruajtur fenë e krishterë sot do të kishin qenë shumë më tepër, por nuk do të ishin më shqiptarë".



REGJISTRIMI I POPULLSISË APO HAPJA E KUTISË SË PANDORËS

PËRGATITI: ROALD A. HYSA

Ky është regjistrimi i dytë i popullsisë dhe i banesave që pritet të kryhet vitin e ardhshëm në Shqipëri. Autoritetet në Shqipëri tashmë kanë nisur punën për regjistrimin e popullsisë dhe të banesave. Ky projekt ka nisur me hartimin e një pyetësori, në të cilin mendohet të përfshihen edhe pyetjet për vetë-

deklarimin etnik dhe fetar të qytetarëve dhe që përbën një gjë të gjuhës së përbashkët të të gjithë këtij procesi të pritshëm. Në bazë të këtij regjistrimi në të ardhmen do të ndërtohen politikat e brendshme sociale të qeverive, por gjithashtu edhe politikat e jashtme me fqinjët tanë, si dhe me shtetet e tjera, të cilët kanë përparësi në politikën e jashtme diplomatike shqiptare.

Kryetari i Komisionit Qendror për

Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave (REPOBA), ministri i shtetit **Genc Pollo** ka thënë për mediet se ky regjistrim do t'i shërbejë mirëqeverisjes dhe zhvillimit institucional të saj. “Risia e këtij regjistrimi është se përmban edhe pyetjet për përkatësinë fetare dhe etnike.” Procesi i regjistrimit, që do të përfshihet në një proces që kushton 15 milionë euro, do të kryhet nga Instituti i Statistikave i mbështetur nga ekspertë të BE-së. Sipas qeverisë regjistrimi do të japë një panoramë aktuale dhe të saktë të realitetit demografik, ekonomik dhe social në vend. Fill pas njoftimit zyrtar për miratimin në parim të pyetësorit përkatës, në vend kanë vërshuar edhe kritikët e para në media nga politikanë dhe qytetarë të thjeshtë ndaj pyetjeve për vetëdeklarimin etnik dhe fetar.

Politikani i njohur **Sabri Godo** i tha BBC-së se qeveria shqiptare nuk duhet të ngutet, por duhet të pyesë paraprakisht qytetarët nëse duan të vetëdeklarohen për etninë dhe fenë apo jo. “Shumë shqiptarë e kanë ndërruar fenë dhe etninë me dokumente të rreme për shkaqe që dihen. Ata duhen pyetur paraprakisht me anë të një sondazhi, nëse i duan këto pyetje.” Ndërsa historiani dhe politikani **Pëllumb Xhufi** për këtë problem thotë: “E konsideroj tradhtinë e radhës ndaj interesave të vendit, një lëshim të turpshëm ndaj presioneve të qarqeve nacionaliste greke, zyrtare e jozyrtare, që kërkojnë të zbatojnë deri në një projektin nacionalist të tjetërsimit të Shqipërisë së Jugut (“Vorio-Epiri”).” Ndër shumë politikanë dhe qytetarë ka drojë se regjistrimi mbi bazë fetare dhe etnike në vend do të sillte një rritje artificiale të numrit të minoritarëve dhe kryesisht të atyre grekë në Shqipëri. Kryetari i Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave, Genc Pollo thotë se në pyetjet për përkatësinë fetare dhe etnike

“...Ndër shumë politikanë dhe qytetarë ka drojë se regjistrimi mbi bazë fetare dhe etnike në vend do të sillte një rritje artificiale të numrit të minoritarëve dhe kryesisht të atyre grekë në Shqipëri...”

qytetarët kanë një alternative që të mos përgjigjen. Në intervistën e tij për gazetën “Shqip”, zotëri Pollo sqaron gjithashtu se regjistrimi i popullsisë mbi baza etnike dhe fetare është rekomanduar nga Brukseli, porse vendimi është i qeverisë shqiptare, sikundër edhe përgjegjësia për këtë vendim. Por megjithëse i bindur se vendimi i marrë është i drejtë, ministri i Shtetit thotë se do të kryhet një konsultim gjashtëmujor, përpara se ai të marrë formë të prerë. Ndërkaq ai vëren: “Por perspektiva historike do të na ndihmonte ta kuptonim edhe më mirë. Në vitin 1930, 5 vjet mbasi kishte konsoliduar pushtetin dhe vetëm 10 vjet pas funksionimit de facto të shtetit shqiptar, Mbreti Zog urdhëroi një regjistrim popullsie që përfshinte edhe etninë e fenë. Në atë kohë të pasigurt midis dy luftërave botërore Shqipëria nuk kishte as garancitë e NATO-s, as statusin kandidat në BE dhe as traktatet dypalëshe, të cilat i ka sot. Argumentet kundër që po dëgjojmë tani me siguri janë paraqitur me alarm edhe atëherë; po në fund të fundit historia i dha të drejtë vendimit politik të atij viti. Veç të dhënave etnike e fetare, ai regjistrim sjell të dhëna shumë të çmuara statistikore për shoqërinë shqiptare asokohe vërtet të panjohur e të paeksploruar. Por të kthehemi

në ditët tona. Nëse kjo çka planifikojmë të bëjmë në vitin 2011 do të ishte propozuar për vitet '90-të, rezervat do të kishin qenë të justifikuara. Shqiptarët e sapodalë nga regjimi komunist ishin tejet të demoralizuar dhe në një vobektësi poshtëruese krahasuar me fqinjët. Sot, në fund të dekadës së parë të shekullit të ri, ne jemi një komb në ngritje dhe një shoqëri me vetëbesim. Kjo pas zhvillimeve historike të këtyre viteve dhe deklarimit zyrtar të institucioneve financiare ndërkombëtare se Shqipëria u ngjit nga kategoria e vendeve me të ardhura të ulëta në atë me të ardhura të mesme.”.

Nuk mund të lemë këtu pa përmendur se në të gjithë Perëndimin Shqipëria njihet gjerësisht si një vend me shumicë muslimane dhe vërejtjet e presidentit Bush, i cili e vizitoi Shqipërinë edhe për këtë shkak qenë krejtësisht pozitive pavarësisht nga frazat e fryra stereotipe të të gjithë atyre që mundohen ta injorojnë këtë fakt shumë të rëndësishëm për të shkuarën dhe të tashmen e të gjithë shqiptarëve etnikë kudo ku jetojnë ata. Tashmë kutia e Pandorës është hapur, rrethanat historike kanë ndryshuar krejtësisht dhe shqiptarët nuk mund të fshihen pas gishtit. Le të kujtojmë një thënie të rilindësit Faik Konica, që “Shqiptarët po të kishin ruajtur fenë e krishterë sot do të kishin qenë shumë më tepër, por nuk do të ishin më shqiptarë”. ■

PENGOHET FALJA E XHUMASË NË XHAMINË E PRILEPIT

Muslimanët e qytetit të Prilepit (Maqedoni) nuk arritën të falin namazin e xhumasë (19.02.2010), pasi një grup qytetarësh maqedonas i penguan ata të futen në oborrin e xhamisë së qytetit, e njohur si xhamia e Çarshisë, por e djegur gjatë konfliktit të vitit 2001.

Për tejkalimin e kësaj situate, besimtarët muslimanë i kanë drejtuar thirrje BFI-së dhe partive politike të ndërhyjnë në zgjidhjen e kësaj çështje. Pas presioneve të shumta nga qytetarët e Prilepit, besimtarët muslimanë e falën namazin e xhumasë në lagjen e tyre. Në këtë xhami besimtarët kanë falur që prej vitit 2001, vetëm namazin e Bajramit. Xhamia në qendër të Prilepit është djegur më 8 shtator 2001 dhe me gjithë lejen për ndërtim deri tani nuk është ndërmarrë asnjë angazhim konkret nga ana e pushtetit qendror dhe ai lokal për riparimin e saj. (Alsat-M)

...

VANDALIZOHET NJË XHAMI NË SHBA

Persona të panjohur vandalizuan një xhami në Neshvill të SHBA-ve. Disa kryqe dhe një mesazh urrejtjenxites ishin shkruar në muret e qendrës rinore të xhamisë, ku thuhej se Islami po e shkatërron SHBA-në. Forcat policore thonë se hetime po bëhen në vendin e ngjarjes, duke dyshuar për sulmin si urrejtje ndaj muslimanëve.

Ky është sulmi i parë që ka pësuar kjo xhami, por nuk është i pari i këtij lloji në këtë rajon. Një xhami në Kolumbia, afër 30km larg Neshvillit, i është vënë zjarri në vitin 2008 nga një person, i cili po vuan dënimin me 14 vjet burg për këtë rast. (Foxnews)

...

SIMPOZIUM “EKONOMIA E KRAHASUAR” NGA OIR-I

Organizata ‘**Imazhi rinor**’, me qendër në Shkodër, organizoi një seminar me temën ‘*Ekonomia e krahasuar!*’ Referatin e parë e mbajti pedagogia në Universitetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik, **Ardita Bylo**, e cila hodhi dritë mbi ‘Filozofinë e ekonomisë marksiste’ dhe pasojat! Më pas referoi pedagogu i Universitetit Evropian të Tiranës, **Artan Gjergji**, i cili referoi mbi ‘Ekomininë Kapitaliste’, duke u përkufizuar mbi tezën, se: A dështoi kapitalizmi dhe ekonomia e tregut në krizën e fundit financiare? Një nga vërejtjet më të rëndësishme të bëra nga A. Gjergji ishte se: “Bankat Islame nuk e ndjenë krizën e fundit financiare për shkak se ato nuk e pranojnë interesin (kamatën), si dhe në sektorin e investimeve banka së bashku me investuesin marrin përsipër së bashku edhe rrezikun e humbjes, gjë e cila nuk ndodh me bankat konvencionale. Në referatin e fundit, ekonomisti **Vehap Kola**, hodhi dritë mbi ‘Ekonomiksin islam; çfarë është dhe si u zhvillua ai?’. Në këtë eveniment me rëndësi, merrnin pjesë ekonomistë të ndryshëm, pedagogë të fakultetit ekonomik, bankierë, studentë të ekonomisë etj. (AlbIslam)

...

PADI PËR SHKAK MISHIT TË DERRIT

Prefekti i qytetit të Boubaix, që gjendet në veri të Francës ka ngritur padi ndaj një restoranti lokal për ushqim të shpejt “Quick”, meqë nuk shet hamburger me mish derri. “Quick” ka vendosur që të zëvendësojë mishin e derrit me atë të fazanit, me të cilin u kthye në restorant “hallall” dhe muslimanët kanë mundësi pa dyshim të hanë hamburgerët e këtij restoranti.

Para disa muajve “Quick” ka eksperimentuar duke futur ushqimin “hallall” në zinxhirin e restoranteve në Francë. Mishin e derrit e ka larguar nga menyuja, ndërsa mishin i lopës vjen nga thertoret hallall. Kontrollin e mishit e bën xhamia Evryju, duke vërtetuar se punohet sipas rregullave “hallall”.

...

ASGJË KONKRETE PËR BURMALI XHAMINË

Vazhdon odiseada për Burmali xhaminë. Asnjë përgjigje konkrete nuk ka ardhur në adresë të BFIM-së, e as të Këshillit Koordinues të Burmali xhamisë, nga asnjë institucion zyrtar. Sipas “Alsat-M”, mësohet se është realizuar një takim mes Gruevskit dhe Ahmetit, ku është arritur një marrëveshje, që sheshi i Shkupit të reflektojë karakterin multi-etnik të vendit. Jo zyrtarisht merret vesh, se nuk është arritur ndonjë marrëveshje konkrete rreth

kishës, por në parim Gruevski dhe Ahmeti kanë rënë dakord, që të tërhiqet vendimi për kishën, ose në rast se do të ketë kishë, atëherë të ketë edhe xhami.

Sipas Këshillit Koordinues për Burmali xhaminë asnjë marrëveshje nuk do të ishte e pranuar, nëse nuk vendoset që pronësia e tokës t'i kthehet Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë. Gjithashtu edhe BFIM ka përsëritur kërkesën që t'i kthehet toka, ku më parë ka ekzistuar xhamia Burmali.

...

SHQIPËRIA LE ANASH RESTAURIMIN E XHAMIVE

Ndërhyrje për rehabilitimin dhe restaurimin e qendrave historike, monumenteve të kulturës dhe objekteve të kultit në të gjithë Shqipërinë, janë ato çfarë shihen si parësore nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për investimet e këtij viti. Në asamblenë e dytë vjetore mbi turizmin në Shqipëri, organizuar nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) dhe MTKRS, ministri Ferdinand Xhaferaj kishte shpallur listën e objekteve ku do të ndërhyhet.

Ndërhyrjet që pritet të bëhen në kuadër të turizmit kulturor janë përmendur për restaurimet në qendrën historike të Beratit, rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik në Durrës, restaurimin e Teatrit të Sofratikës, muzeu Arkeologjik në Korçë, restaurimin e Kishës Shën Maria në Lubonjë, e po ashtu restaurimin e banesës së Oso Kukës, Pashko Vasës, Gjergj Fishtës, banesa Kazani dhe ajo e Petro Markos. Po në kuadër të objekteve të kultit që gjenden në Shqipëri, pritet të restaurohet edhe Teqja e Sheh Dyrri, por edhe Kisha e Shën Janit. Duke parë planin e Ministrisë në fjalë, vërejmë se në projektet e restaurimit nuk është paraparë asnjë xhami, të cilat janë në gjendje jo të mirë.

...

DUBAI I SIGURT: MOSSADI VRAU ZYRTARIN E HAMASIT

Shefi i policisë së Dubait deklaroi se ishte 99 për qind i sigurt, që Izraeli kishte kryer vrasjen e zyrtarit të lartë të Hamasit në Dubai. “Hetimet tona thonë se Mossadi (shërbimi sekret izraelit) është përfshirë në vrasjen e muajit janar të Mahmud al-Mabhuhut. Është 99 për qind e sigurt, për të mos thënë 100 për qind, se pas kësaj vrasjeje qëndron Mossadi”, deklaroi shefi i policisë, Dahi Halfan Tamim për gazetën “The National”.

“Përdorimi i pasaportave false në kuadër të vrasjes së Mahmud Abdel Raouf Al-Mabhuh, më 20 janar në një hotel në Dubai përbën një incident shumë serioz”, deklaroi Ministri në radiotelevizionin “RTE”.

Përgatiti: Hajrush MANI

DHUNA DHE RIKTHIMI I TË RINJVE NË FE

Ky shkrim u dedikohet atyre djemve të rinj, që janë futur në fe dhe nuk i dinë disa rregulla elementare dhe thelbësore të fesë dhe atyre që lejojnë që të përzihet ana fetare me atë që është kalitur me disa tipare autoktone shqiptare, siç është inati, zemërimi dhe nxitimi

SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Pas një kohe të gjatë të kaluar në injorancë të thellë mbi fenë tonë erdhi koha e rikthimit në këtë fe, njohjen dhe mësimin e kësaj feje. Ky mësim u shoqërua edhe me praktikim dhe realizimin e asaj që mësojnë të rinjtë në vende të ndryshme.

Ky ndryshim që po ndodh në shoqërinë tonë, jo çdo herë është mirëpritur nga shtresa të caktuara të shoqërisë tonë, sidomos të një pjese që llogariten si lider të opinionit publik. Ata në shumë raste e kanë

kritikuar këtë fenomen në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo dhe janë munduar t'i japin atë trajtë që ata dëshirojnë të jetë dhe jo të asaj që në realitet është. Krejt kjo për të ndalur hovin e kthimit të të rinjve në fe. Prandaj edhe çdo incident të izoluar ata janë munduar ta bëjnë të zhurmshëm dhe ta llogarisin si argument për tezën që ata gjatë gjithë kësaj kohe e kanë lansuar.

Protagonistët e këtij qëndrimi e fillojnë me tezën se identiteti ynë kombëtar nuk ka asgjë orientale në përbërjen e vet, deri tek ata që mendojnë se elementi fetar e



thërmoka identitetin tonë kombëtar!

Sidoqoftë qasja që ata i bëjnë këtyre fenomeneve, këta njerëz dhe shtresa, ne si muslimanë e kemi për detyrë të jemi edhe autokritikë, nëse ka dukuri të këtilla negative në shoqërinë tonë. Prandaj edhe ky shkrim u dedikohet atyre djemve të rinj, që janë futur në fe dhe nuk i dinë disa rregulla elementare dhe thelbësore të fesë dhe atyre që lejojnë që të përzihet ana fetare me atë që është kalitur me disa tipare autoktone shqiptare, siç është inati, zemërimi dhe nxitimi.

Prania e një pjese të injorancës sipas definicioneve fetare në mesin e atyre të sapoudhëzuar në shumë raste krijon reagime të pamatura dhe jo të drejta fetarisht. Në këto raste nuk është shkak i këtyre problemeve fetaria e tij, sa është pjesa tjetër, afetaria, injoranca e tij, që ndikon në shkaktimin e këtyre problemeve.

Intoleranca nuk është veti e njeriut me bindje dhe argumente për bindjet që ka, se sa është rezultat i njerëzve të pashkolluar, të izoluar në shoqëri dhe të paafte për të krijuar mekanizma të mjaftueshme për të ndryshuar realitetin, i cili nuk i pëlqen.

Një fetar i mirë musliman nuk është intolerant, sepse besimi i tij mbështetet në fakte dhe argumente, është i hapur me shoqërinë, sepse ai e do të mirën dhe udhëzimin e saj dhe ka shumë mënyra fetare, të cilat i ka treguar Allahu Fuqiptotë në Kuran dhe Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në thëniet e tij për ta ndryshuar shoqërinë.

Nëse ndodh që ndonjë i ri musliman tek i cili shihen disa simptoma të fetarisë së tij, që bën gabime të kësaj natyre duhet të kuptojmë, se ai akoma nuk i ka kuptuar gjërat e shënuara më poshtë.

Thirrja Islame ka synime të qarta, më kryesorja prej tyre është udhëzimi i njerëzve në besimin tek Allahu Një dhe pa

“...Ndryshimi i njerëzve është një proces i gjatë, që nuk mund të ndodhë për një natë, por duhet një kohë e gjatë dhe etapa të njëpasnjëshme deri sa të arrijmë qëllimin...”

dyshim se mënyra më e mirë për të arritur qëllimin e duhur në këtë drejtim është përdorimi i butësisë e jo i dhunës. Vetë Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka treguar se atë që mund ta fitojmë me butësi nuk mund ta fitojmë me dhunë duke na rrëfyer: *“Allahu është i Butë dhe e do butësinë, prandaj i jep butësisë atë që nuk ia jep dhunës”*. (Sahih, Ebu Davudi). *“Aishe bëhu e butë, sepse kudo që gjendet butësia ajo gjë është e bukur dhe kudo ku nuk gjendet butësia, ajo është e shëmtuar”*. (Sahih, Ebu Davudi).

Nga synimet e thirrjes islame është edhe përhapja e vlerave të Fesë Islame, të cilat pa dyshim që kanë synim mbizotërimin e mirëqenies dhe lumturisë në shoqëri. Këto veprime nuk mund të realizohen në mungesë të urdhërimit për mirë, largimit nga e keqja, arsimimit dhe edukimit të muslimanëve në këtë fe, shtimit të mirësisë dhe zhvillimit të kësaj shoqërie.

Një njeri, i cili i synon këto gjëra duhet të pajiset me disa veti, të cilat e ndihmojnë në realizimin e këtyre synimeve shumë sublime. Dijetarët muslimanë sa herë që kanë folur për këtë temë kanë përmendur cilësitë e atij që thërret në fenë e Allahut, e mes tyre kanë përmendur sinqeritetin, dijen, shembullin e mirë, butësinë, lehtësimin, ndarjen në etapa, njohjen e realitetit të atyre që i thërret dhe urtësinë.

Ibën Kajimi, rahimehullah, thotë: “Meqë thirrja në fenë e Allahut është pozita më e ndershme, më e madhe dhe më e vlefshme e besimtarit, duhet ditur se ajo nuk arrihet pa dije mbi atë që thërret dhe pa dije mbi mënyrat se si thërret. Nëse një njeri dëshiron ta ketë thirrjen e plotë ai duhet të zotërojë aq dije sa i mjafton për ta arritur këtë qëllim”. (shiko: “Miftahu Darus-Seadeti”,1/154).

Hatib Sherbini në librin “Mugnil-Muhtaxh” thotë: “Në çështjet e ndjeshme vetëm dijetari urdhëron në të mirë dhe ndalon nga të këqijat, kjo nuk i lejohe masës së gjerë... prandaj qortohet ai që merr vend për të dhënë mësim, apo fetva, apo këshillë, duke mos qenë i aftë për një gjë të tillë”. (4/212). Dijetarët muslimanë duke komentuar ajetin kuranor: **“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta (basirah), e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.”** (Jusuf: 108) thonë: **Basirah**, është grada më e lartë e dijes. Basirah, gjatë thirrjes në fenë e Allahut nënkupton tre gjëra:

- të njohë dispozitat fetare rreth asaj në të cilën thërret,
- të njohë mirë gjendjen e atij që e thërret, dhe
- të njohë mirë mënyrat e thirrjes.

Allahu, *subhanehu ue teala*, i ka hartuar

“Muslimani që përzihet me njerëz dhe i duron lëndimet e tyre është më i mirë, se njeriu që nuk përzihet me njerëz dhe nuk duron dëmtimet e tyre...”

planet dhe mënyrat e thirrjes në shumë ajete kuranore”. (“El-Himmetu fid-Daveti ilall-llah”, fq. 38-39).

Sipas të gjitha këtyre sqarimeve dhuna nuk ka vend askund dhe nuk është as veti e as formë e kërkuar për të thirrur në fenë e Allahut! Nëse i analizojmë një nga një këto tipare dhe cilësi, që duhet të zotërojë një njeri që thërret në fenë e Allahut, do të kuptojmë shumë gjëra. Do të kuptojmë se nuk mjafton vetëm sinqeriteti në mungesë të dijes për ta bërë një vepër të mirë. Do të kuptojmë se nuk mjafton vetëm fjala e thatë pa dhënë edhe shembull konkret nga përditshmëria jonë. Do të kuptojmë se thirrja në fenë Allahut nuk nënkupton aspak vështirësimin e jetës së njerëzve, por lehtësimin dhe përmirësimin e saj.

Do të kuptojmë se ndryshimi i njerëzve është një proces i gjatë, që nuk mund të ndodhë për një natë, por duhet një kohë e gjatë dhe etapa të njëpasnjëshme deri sa të arrijmë qëllimin.

Do të kuptojmë se sipas vendit bëhet edhe kuvendi, e nuk vlen e njëjta fjalë dhe mënyrë në çdo vend dhe për çdo njeri, por duhet të përdorim mënyra të veçanta dhe të ndryshme për çdo vend dhe çdo njeri. Do të kuptojmë se në mungesë të urtisë shumë tentativa dhe orvatje për të bërë mirë mund të na dalin sherr, fatkeqësisht kjo po ndodh shumë shpesh me njerëzit e sapoudhëzuar.

Urtësia është një komponentë, që fatkeqësisht po na mungon shumë në jetën tonë të përditshme, e cila ka kuptimin e “të kesh besim, fjalë dhe vepra të sakta. Ose të vendosësh çdo gjë në vendin e vet me saktësi dhe përsosmëri”. (shiko: “El-Hikmetu fid-Daveti ilAll-llah”, fq. 30)

Pa dyshim që pjesë e urtësisë është vlerësimi i dëmit dhe i dobisë në përdorimin e masave të caktuara gjatë komunikimit me një shtresë të caktuar, sepse shpeshherë ndodh që braktisja e disa fjalëve është më e

arsyeshme dhe lënia e disa veprimeve më e dobishme. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka dhënë shumë udhëzime në këtë drejtim, prej tyre janë edhe këto hadithe: *“Muslimani që përzihet me njerëz dhe i duron lëndimet e tyre është më i mirë, se njeriu që nuk përzihet me njerëz dhe nuk duron dëmtimet e tyre”*. (Hadithi është sahih, Tirmidhiu). Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur dërgoi dy shokët e tij në Jemen për të thirrur në fenë e Allahut, mes të tjerave i porositi: *“Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos dëboni dhe pajtohuni mes vete dhe mos u përçani”*. (Buhariu dhe Muslimi).

Qëllimi i thirrjes në fenë Allahut është udhëzimi i atyre që i thërrasim e assesi hakmarrja, ofendimi ose nënçmimi i tyre. Duke u nisur nga tërë kjo që thamë dhe një sërë argumentesh të tjera të shumta, që s’kemi arritur t’i themi duhet t’i bëhet shumë e qartë djelmohave muslimanë, se thirrja në fenë e Allahut është:

- Art dhe kërkon ndjeshmëri shumë të madhe.
- Dije dhe duhet mësuar nga dijetarët.
- Përvojë dhe duhet mësuar nga më të vjetrit.
- Butësi e assesi dhunë dhe ashpërsi.
- Udhëzim e assesi hakmarrje.

Allahun e lusim të na japë dije të dobishme dhe vepra të mira, të na japë sinqeritet në fjalë dhe vepra dhe të na bëjë çelës të veprave të mira dhe mbyllës të veprave të këqija. Amin! ■

POPULLI I ZGJEDHUR I ZOTIT?!

Allahu ka vënë rregull, që elementi përcaktues për prijatarin është vetëm devotshmëria dhe kjo gjendet edhe në libra të tjerë pos Kuranit: *“Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Leevi Mahfudh) se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë”*.

SHKRUAN: SEDAT ISLAMI

Thirrja e një populli në nivel ndërkombëtar, a një kombi brenda një shteti, në parime të njëanshme, që përcaktojnë epërsinë e tij mbi të tjerët, gjithnjë ka prodhuar skena të tmerrshme dhune, gjenocidi, masakrash e krimesh të tjera makabre. Gjendja është përshkallëzuar më keq, atëherë kur këtë epërsi racore e kanë mbështetur jo gabimisht, por qëllimshëm me parime fetare apo filozofike, të futur nëpër nene kushtetutash. Përkrahja ose thënë me mirë vendosja e këtij parimi famëkeq nga filozofë të mëdhenj, siç ishte Platoni¹, bëri që në kulturat antike, siç ishte ajo greke dhe romake, jeta e popujve të nënshtruar të ishte aq e pavlerë, saqë mohimi i saj merrej për argëtim dhe zbavitje. Arenat e gladiatorëve, që sot i shohim vetëm nëpër filmat të rrëqethin ishin një realitet, madje edhe shumë më i hidhur...

¹ Dr. Sabir Amed Taha, Er-Riku fi’l Jehudijjeti ue’n Nasranijjeti ue’l Islam, përktheu: Sedat Islami, b. 1, botues: Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 2008, f. 16.



Në përgjithësi motivet (e edhe bazat) e këtij fanatizmi përgjatë historisë, kanë qenë tri:

Kultura, siç ishte rasti me grekët dhe romakët²,

Raca, siç është rasti me amerikanët e bardhë ndaj të zinjve, dhe

Feja, siç është rasti me çifutët.

Mund të ketë edhe motive të tjera, por këto janë më të theksuarat.

Ky punim sigurisht se nuk do të trajtojë dy motivet e para për faktin se ato, nëse nuk kanë pushuar së vepruari, të paktën ndonjë ndikim të madh tashti për tashti nuk kanë. Do të përqendrohemi në elementin e tretë, meqë është duke na kushtuar më shumë neve muslimanëve, gjithmonë si palë e dëmtuar. Pretendimi i çifutëve në mbivlerën e tyre ndaj të tjerëve, e në veçanti ndaj arabëve, jo vetëm që pati për pasojë uzurpimin e tokave “legendare” dhe

shkaktimin e **fesadit** në tokë, por edhe mori mijëra jetë të pafajshme.³

Çifutët u zgjodhën...

Ndonëse me mospajtime rreth elementit përcaktues të përzgjedhjes me çifutët e sotshëm, një problematikë që do ta rrahim në kuadër të këtij punimi, çifutët monoteistë u nderuan nga Allahu me favore që as të tjerët më parë, por as popujt e tjerë me të cilët bashkëjetonin nuk i kishin. Kjo për faktin se në pjesën më të madhe të botës mbretëronte idhujtaria, ndaj përzgjedhja e vështruar nga ky kënd do të ishte më e logjikshme. Allahu thotë: **“Ne i patëm zgjedhur ata** (besimtarët beni israilitë) **me vetëdije ndër njerëzit e asaj kohe”**. Duhan, 32; **“O Bijtë e Israilit, përkujtojeni dhuntinë Time, të cilën ua dhurova, dhe Unë ju pata dalluar ndaj njerëzve të tjerë** (të asaj kohe)”. Bekare, 47; **“Ne u patëm dhënë beni israilëve**

² Grekët i ndanin popujt në dy grupe: Grekë (ose superiorët, që e meritojnë udhëheqjen) dhe barbarë (ku bënin pjesë të gjithë popujt e botës), të cilët duhej t'i shërbenin atyre. Ibid, fq. 16.

³ Ky punim është i bazuar në artikullin e Dr. Munkidh b. Mahmud Sekkar-it, Allahu e ruajt, i publikuar në <http://www.saaidd.net/Doat/mongiz/1.htm>.

librin dhe peygamberllëkun dhe aftësi për të gjykuar midis njerëzve, i patëm furnizuar ata me të mira dhe i patëm dalluar nga njerëzit e tjerë". Xhathije, 16.

Çifutët përbuzës dhe mosmirënjohës

Këto privilegje padyshim që i morën prej Allahut, por në vend të falënderimit e mirënjohjes për to ata shfaqën kryelartësi dhe mosmirënjohje. Raportet në lidhje me Allahun i ndërjuan mbi bazat e interesit të tyre; nëse urdhrat qiellore nuk ndesheshin me qejfet dhe tekat e tyre i praninin, përndryshe jo vetëm që i refuzonin ato, por edhe nuk i kursenin nga shpifjet apo edhe vrasjet bartësit e tyre, profetët. Dhuntitë vetëm sa ua shtuan agresivitetin dhe kryeneçësinë. Duke filluar nga kundërshtimi i Allahut dhe profetëve⁴, përshkrimi i tyre me cilësi nënçmuese⁵, luftimi i tyre⁶, çifutët shkuan aq larg sa që jo vetëm që kërkuan një zot pos Allahut⁷, por edhe punuan një viç prej ari, të cilin filluan ta adhurojnë⁸. Ja kështu i kthyen të mirat çifutët.

Loja ka rregulla...

Çifutët i shkelën rregullat dhe nuk i përmbushën detyrimet. Ata i harruan ato, iu interesonin vetëm të drejtat. Ata i anashkaluan dy kushtet kryesore për të drejtën e mbajtjes së këtij titulli:

1. Përzgjedhja është e ndërtuar mbi lidhjet me Allahun e jo në themele të tjera, siç pretendojnë çifutët. Raca e tyre ishte ajo që ata mendonin gabimisht, se i ka ngritur. Se është mohuar kjo gjë e dëshmon edhe ky ajet kuranor, i cili fjalët e Allahut që iu

drejtuan atyre **"O bijtë e Israilit, përkujtoni mirësitë e Mia ndaj jush..."**, i komenton si qortime ndaj shkeljeve dhe thirrjeve në baza të kota, sikurse kjo: **"Musai tha: "Mos deshët, pos Allahut, të kërkoh për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?"**". Arafë, 140.

Pra, Allahu ju ngriti juve si monoteistë (ky është themeli), kurse ju dëshironi ta mohoni Atë që ju nderoi?! Pastaj, thirrja në këtë parim bie ndesh me vetë ligjet bazë të Allahut, sepse njerëzit që të gjithë janë robër të Tij dhe që të gjithë janë prej Ademit, alejhi selam. Pra, përkatësia e të gjithëve është një, kurse krenaria është e të singertëve. Pejgamberi, alejhi selam thotë: **"Njerëzit janë bijtë e Ademit, kurse Allahu e krijoi Ademin nga dheu"**.

Nga këtu del se Allahu ka vënë rregull, që elementi përcaktues për prijatarin është vetëm devotshmëria dhe kjo gjendet edhe në libra të tjerë pos Kuranit: **"Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehvi Mahfudh) se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë"**. El Enbija, 105.

2. Mandati i këtij titulli nderi është i pacaktuar. Zgjatja apo konfiskimi varen nga besnikëria ndaj marrëveshjes paraprake. Duke qenë se ata ndryshe besonin¹⁰ e ndryshe ishte realiteti, mandati i këtij nderi vihej në pikëpyetje të madhe. Allahu që më parë u kishte treguar se titulli i nderit është nder reciprok ndërmjet Tij dhe atyre; e respektojnë Atë, i nderon ata, e mohojnë, i poshtëron. Allahu tha: **"O Bijtë e Israilit,**

⁴ Se çfarë forme duhej përdorur për ta respektuar dhe përfillur urdhrin e Allahut shih Bekare, 63. Kurse për sa i përket kundërshtimit të profetëve, kthehu tek ato që i bënin Musait, alejhi selam: Maide, 20-24.

⁵ Për Allahun thanë gjëra shumë të këqija. - I përshkruan fëmijë: Teube, 30; - I përshkruan koprraci dhe varfëri: Maide, 64; Ali Imran, 181. Kurse profetët i akuzuan rëndë, madje edhe në moral.

⁶ Ali Imran, 78; Bekare, 87.

⁷ Arafë, 140.

⁸ Arafë, 148-151.

⁹ Hadithi është hasen. Shih: Sahihu'l xhamii, 7867.

¹⁰ Ata besojnë se ky titull nderi është i përhershëm. Shih: Dhjata e vjetër, Zanafilla, 17:7.

“...Vendosja e këtij parimi famëkeq nga filozofë të mëdhenj, siç ishte Platoni, bëri që në kulturat antike, siç ishte ajo greke dhe romake, jeta e popujve të nënshtruar të ishte aq e pavlerë, sa që mohimi i saj merrej për argëtim dhe zbavitje...”

kujtoni (jini mirënjohës për) *të mirat e Mia, të cilat ua dhurova juve dhe zbatoni premtimin që ma keni dhënë Mua. Unë e zbatoj atë që ju premtova dhe të më keni frikë vetëm Mua*”. Bekare, 40. Kështu, sipas ligjit të Allahut, kur dikujt i jepet një e mirë dhe ai e kthen me të keqe, apo e përbuz atë, ajo gjë i merret. Allahu thotë: *“Pyeti Bijtë e Israilit, se sa argumente të qarta u kemi dhënë atyre (dhe nuk besuan). E kush e ndërron të mirën e Allahut pasi t’i ketë ardhur ajo, s’ka dyshim se ndëshkimi i Allahut është i ashpër*”. Bekare, 211. Kështu, si pasojë e kësaj erdhi deri tek:

Konfiskimi i titullit të nderit

Çifutët e kishin tejkaluar çdo normë dhe kufi, dhe tashmë jo vetëm që nuk bëhet fjalë për zhveshje nga nderi dhe krenaria, por edhe tërhoqën mbi vete hidhërimin e Allahut, mallkimin e Tij dhe të profetëve, madje edhe u ndëshkuan me dënime nga më të vrazhdat¹¹. Jo vetëm abuzimet, krimet dhe morali i tyre

qenë shkak i këtij konfiskimi. Përcaktimi kohor i misionit të Musait, *alejhi selam* këtë privilegj e kishte vënë në siklet. Mu për këtë ata e prisnin me padurim ardhjen e profetit të fundit nga radhët e tyre për të vazhduar deri në amshim me këtë titull, por nuk ndodhi ashtu. Profeti i ri dhe i fundit në të njëjtën kohë erdhi nga ata, ndaj të cilëve çifutët shfaqën epërsi racore me dëshmi fetare¹².

Prestigi i muslimanëve

Nuk do të duhej kuptuar me këtë ndonjë tendencë ekstremiteti për faktin se edhe një çifut që do të pranonte Islamin, siç është rasti me Abdullah b. Selamin e shumë të tjerë, që nga koha e Pejgamberit, *alejhi salatu ue selam* e deri më sot do të gëzonte këtë nder. Ky titull ka karakter universal dhe në të shkrihet çdo racë, komb, shtet, me kushtin paraprak të pranimit të tij. Pastaj vetë muslimanëve kjo iu kushtëzua me atë që iu kushtëzua edhe çifutëve. Allahu thotë: *“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun. E sikur Ithtarët e Librit të besonin drejt do të ishte shumë më mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit*”. Ali Imran, 110. Ki kujdes, për këtë edhe na është tërhequr vërejtja, që të mos trasojmë rrugën e atyre që ishin para nesh, e me theks të veçantë çifutëve, sepse do të tërhiqim nga pas hidhërimin e Allahut. Pejgamberi, *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *“Do të pasoni traditat e atyre që kanë qenë para jush pëllëmbë pas pëllëmbë, llërë pas llërë, sa që po të hynin ata në vrime të hardhucës, ju do t’i pasonit*”. I thamë: *Kush janë ata, Çifutët dhe të Krishterët?... -Tha: “Kush tjetër përpos tyre?”*¹³.

¹¹ Ali Imran, 112; el-Bekare, 88; el-Maide, 78; el-Bekare, 65; el-Maide, 60.

¹² Thanë se arabët rrjedhin nga Ismaili, i biri i robëreshës, Haxheres, kurse ata nga Is’haku, i biri i Sares, zonjës.

¹³ Buhariu dhe Muslimi.

Zhveshja e muslimanëve nga ky privilegj

Edhe tek muslimanët është e kushtëzuar njësoj, sikurse tek popujt e mëhershëm, siç përmendëm ajetin 110 të kaptinës Ali Imran, porse kalimi nga muslimanët në pasues të feve të tjera nuk ndodh. Kjo për faktin se Islami është përmbyllja e feve, është përmbledhja e tyre, është feja, e cila nuk i është lënë njeriut në ruajtje, por Allahu e ka marrë përsipër atë. Kështu, nëse ndodh që në ndonjë vend muslimanët të jenë indiferentë ndaj rolit të tyre, atëherë konfiskimi i këtij nderi bëhet automatikisht dhe ai i kalohet një grupi tjetër muslimanësh në një vend tjetër. Allahu thotë: **“Nëse nuk dëlmi (në luftë), Ai do t’ju dënojë me një dënim të rëndë, ju zëvendëson me një popull tjetër dhe Atij nuk i bëhet farë dëmi. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë”**. Teube, 39.

Në komentin e këtij ajeti, siç e kanë përmendur Ibën Kethiri dhe Ebu Suudi në Tefsiret e tyre, Allahu paralajmëron se ata që nuk e përkrahin profetin e Tij, do t’i ndërrojë me njerëz të tjerë, të cilët do ta ndihmojnë dhe do ta mbështesin atë¹⁴, dhe të cilët, sipas Ebu Suudit¹⁵ mund të jenë nga racë apo edhe popuj të tjerë. P.sh., nëse nuk e përkrahin arabët, e përkrahin persianët. Ndoshta këtu qëndron sekreti i kalimit të pushtetit të muslimanëve nga një shtet në shtetin tjetër.

Shkaqet e këtij ndërrimi

Ashtu sikurse kushtet, edhe shkaqet janë pikërisht ato që ishin tek çifutët, prej të cilave, si më të rrezikshmet do të veçonim:

1. Rënia në idhujtari-shirk. Allahu na

lajmëroi se çifutët patën rënë në shirk¹⁶, mëkat ky prej të cilit na e ka tërhequr vërejtjen shumë Pejgamberi, *alejhi salatu ue selam*: **“O ju njerëz! Kini frikë këtë shirk, ngase ai është më i fshehtë se të ecurit e buburrecit”**¹⁷.

2. Frika dhe mosgatishmëria për sakrificë. Këto ishin tipare të çifutëve¹⁸, kurse reflektimi i tyre në shoqërinë muslimane shkakton poshtërsinë dhe nënçmimin, i cili nuk hiqet përderisa të mos kthehemi në fe. Pejgamberi, *alejhi salatu ue selam* thotë: **“Kur të bëni tregtinë me kamatë, e të merrni bishtat e lopëve (të merreni me blegtori), e të kënaqeni me bujqësi dhe ta leni xhihadin - luftën për hir të Allahut, Allahu do ta mbisundojë mbi ju nënçmimin dhe nuk ua heq derisa të ktheheni në fenë tuaj”**¹⁹.

3. Shtrembërimi i parimeve fetare, e në veçanti lejimeve dhe ndalesave²⁰. Pejgamberi, *alejhi salatu ue selam* ka thënë: **“Për umetin tim kam frikë imamët - prijësit që humbin njerëzit nga e vërteta”**²¹.

4. Braktisja e urdhërimit për të mirë dhe e ndalimit nga e keqja²². Distancimi nga kjo, padyshim që paraqet rrezik edhe për dënim nga ana e Allahut.

5. Përçarja në fe²³. Islami urdhëron për bashkim e jo përçarje, unitet e jo ndasi, afrim e jo largim, madje këtë e ka bërë gjatë gjithë historisë njerëzore. Allahu thotë: **“Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të...”**. Shura, 13. ■

¹⁴ Tefsiru’l Kur’ani’l Adhim, Ibnu Kethir, b. 2, 1999, www.qurancomplex.com.

¹⁵ Irshadu’l akli’s selim ila mezaja’l kitabi’l kerim, Ebu’s Suud, Muhammed b. Muhammed b. Mustafa el-Amadi, http://www.altafsir.com.

¹⁶ Bekare, 51; Bekare, 54.

¹⁷ Ahmedi. Ky hadith është hasen li gajrihi.

¹⁸ Bekare, 96; Maide, 20-24.

¹⁹ E përcjellin Ebu Davudi dhe Ahmedi. Albani këtë hadith e ka cilësuar sahih.

²⁰ Ali Imran, 78.

²¹ Albani në Mishkatu’l mesabih e ka cilësuar sahih.

²² Maide, 78.

²³ Rrum, 32; Ali Imran, 105; Fussilet, 54.



HOXHALLARË SHQIPTARË, QË DEKLAROHEN KUNDRA TERRORIZMIT

“Dënojmë çdo propagandë apo aktivitet kriminal që cenon jetën, pasurinë dhe moralin e qytetarëve të këtij vendi, qoftë kjo edhe nën petkun e fesë dhe besimit. Ashtu siç dënojmë dhe abuzimin që bëhet nga persona të ndryshëm, me koncepte të tilla islame, siç është xhihadi, për të justifikuar aktet terroriste që nuk kanë të bëjnë aspak me të.”

Para afro dy muajsh një grup prej dyzet e dy hoxhallarësh shqiptarë, të diplomuar kryesisht në vendet arabe bënë një deklaratë publike, ku distanconin veten dhe muslimanët shqiptarë nga dhuna, qoftë kjo fizike apo verbale, veprimtari e cila tashmë për shkaqe që dihen shihet nga shumëkush si pjesë e pandashme e këtij komuniteti që ata përfaqësojnë, aq sa për një pjesë jo e vogël të njerëzve besojnë me të vërtetë, se është Feja Islame ajo që e ushqen këtë frymë agresive ndaj njerëzve!

Një deklaratë e tillë me të drejtë është dashur të bëhet shumë më herët dhe nevoja e arsyet për të kanë qenë edhe më herët sesa vetë arsyeja që e shkaktoi këtë deklaratë. Gjithsesi përtej rastit pse kjo deklaratë u bë pikërisht në këtë kohë dhe pas x ngjarje, duke u nisur nga logjika islame, e cila thotë se përmbajtjes së përgjithshme tekstuale i jepet përparësi kundrejt rastit konkret që e solli tekstin në ekzistencë, na duhet që realisht ta vlerësojmë këtë deklaratë si tepër serioze, për

më tepër kur pjesa dërrmuese e atyre që e nënshkruan atë janë pikërisht ai kontingjent klerikësh muslimanë të brezit të ri, të cilët shihen pa të drejtë si përfaqësuesit më të dyshimtë të komunitetit të muslimanëve shqiptarë.

Në këtë deklaratë thuhet:

“Dënojmë çdo propagandë apo aktivitet kriminal që cenon jetën, pasurinë dhe moralin e qytetarëve të këtij vendi, qoftë kjo edhe nën petkun e fesë dhe besimit. Ashtu siç dënojmë dhe abuzimin që bëhet nga persona të ndryshëm, me koncepte të tilla islame, siç është xhihadi, për të justifikuar aktet terroriste që nuk kanë të bëjnë aspak me të.”

Pas këtij deklarimi të shkurtër dhe të prerë kundra dhunës, deklarata sqaron një koncept kaq shumë të keqkuptuar dhe të keqngatërruar si xhihadi dhe që identifikohet lehtësisht me dhunën, hartuesit e saj për të thonë:

“Xhihadi në konceptin islam nuk është aspak strehë për dhunën ndaj të pafajshmëve, për prishjen e rendit publik dhe terrorizimin

“Xhiahadi është përpjekje njerëzore për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe vendosjen e drejtësisë, ku njerëzit të shijojnë lirinë që u ka falur Zoti...”

e popullsisë civile. Xhiahadi është përpjekje njerëzore për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe vendosjen e drejtësisë, ku njerëzit të shijojnë lirinë që u ka falur Zoti. Në këtë kuptim ai përfshin në vetvete para së gjithash çdo aktivitet paqësor të besimtarëve, që përpiqen për lartësimin e së mirës. Lufta e armatosur, sipas Islamit, është opsioni i fundit, i padëshiruar, por që mund të ligjërohet vetëm në kushte ekstreme të vetëmbrojtjes dhe nën juridiksionin e një shteti. Zoti për këtë shprehet në Kuran dhe thotë: **“Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërr-ohehin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut.”** (22: 40)”

Më pas deklarata shpreh qartë dhe shkoqur, sesi shihet terrorizmi në sytë e këtyre njerëzve:

“Terrorizmi është përdorimi i dhunës për arsye politike. Për këtë arsye tradita e shenjtë islame është kundra terrorizmit, ashtu si dhe kundra çdo lloj filozofie, ku qëllimi justifikon mjetin, pavarësisht se sa i lartë mund të jetë qëllimi. Por ashtu si fetë e tjera qiellore Hebraizmi dhe Krishterimi, Islami ka një trashëgimi luftarake, xhiahadin, i cili disiplinohet nga konsiderata etike të formuluar qartë në librat themeltarë të fesë. Kjo gjë shprehet qartazi në tekstet fetare, ku lufta konsiderohet si një alternativë e detyruar, në mbrojtje të jetës, fesë dhe pasurisë nga një agresion i jashtëm, si e drejtë themeltare njerëzore për rezistencë ndaj okupimit.”

Deklarata më tej dënon dhe distancohet nga aktet e terrorit, të cilat ndodhin në botë dhe që justifikohen nën petkun e Fesë Islame dhe që s’kanë të bëjnë me xhiahadin:

“Terroristët nuk janë luftëtarët çlirimtarë të xhiahadit, ata janë thjesht kriminelë. Të njëjtosht terrorizmin me xhiahadin është njëkohësisht cenim për besimtarët muslimanë, sepse inkriminon pa të drejtë traditën e tyre, si dhe për të gjithë popullin shqiptar, i cili nuk ka nevojë për prurjen artificiale të tensioneve nga regjione të tjera me tensione politike që nuk janë tonat.”

Në fund deklarata mbyllet duke trajtuar rastin konkret, i cili u bë edhe shkak për këtë deklaratë, duke treguar se teologët në fjalë si njohës më të mirë të të tilla problemeve nuk konstatojnë se kanë të bëjmë realisht me një rast të “nxitjes së terrorizmit”, pavarësisht retorikës së përdorur.

Veç thirrjes që nënshkruarit e kësaj deklarate i bëjnë medieve dhe organeve kompetente të tregohen më profesionistë në trajtimin e një problematike të tillë delikate, për të mos shkaktuar fobira të paqena, mes rreshtave të kësaj deklarate lexojmë qartë se ajo i drejtohet edhe vetë predikuesve të ndryshëm muslimanë shqiptarë për të qenë më realistë në trajtimin e temave fetare dhe për të mos përdorur një ligjërim që jo vetëm lë shteg për keqkuptime, por edhe që nuk i shërben, as muslimanëve, as njerëzve të tjerë në ambientin dhe kohën në të cilin jetojmë, sepse është jashtë kontekstit fetar që ata jetojnë.

Deklarata të tilla nuk duhet të ngelen në letër, por duhet të shërbejnë, si për ata që e nënshkruan, si për ata që u drejtohet, si dhe një pikënisje për një komunikim më të sinqertë dhe më mirëkuptues në mes palëve, natyrisht në radhë të parë janë pikërisht predikuesit e fesë ata që duhet ta bëjnë këtë, për të ndarë me të tjerët sa më prekshëm atë të vërtetë që atyre u mungon. ■

REDAKSIA



TË SHPIFËSH PËR TË PAQENËN?!

Sado që Perëndimi me propagandën e tij mediatike të hedhë akuza të paqena për Islamin, Kurandin dhe muslimanët, përsëri njerëzit që zotërojnë logjikë të shëndoshë e dinë dhe janë të ndërgjegjshëm, se burgjet e inkuizicionit, Guantanamo, Ebu Graibit, përdhunimin e grave dhe të miturve, vrasjen e civilëve dhe pushtimin e shteteve (vetëm për fitime materiale) në emër të lirisë, nuk i kanë ndërmarrë muslimanët, nuk i ka nxitur Kurani, Muhamedi e as Islami, porse vetëm njerëz famëkëqij, të cilët historia dhe njerëzimi do t'i kujtojë si kriminelë lufte

SHKRUAN: BLENDAR HAXHIU

Nuk ka dyshim se që në momentet e para të jetës njerëzore është shfaqur edhe lufta mes të vërtetës dhe të kotës. Kjo luftë është nderur dhe është ashpërsuar më tepër në kohën e të dërguarve e më pas me pasuesit e tyre. Ai që vështron me kujdes në tekstet kuranore, apo edhe në faktet historike do të gjejë një sërë ngjarjesh, të cilat na e

pasqyrojnë këtë luftë. Mjafton vetëm të shfletosh historinë e profetit Ibrahim me Nemrudin¹; të Musait me faraonin²; të Nuhut me popullin³ e tij dhe së fundi të Muhamedit me popullin e tij e do të shpaloset qartë, se e kota dhe pasuesit e saj i kanë përdorur të gjitha metodat e mundshme për ta parandaluar përhapjen e së vërtetës dhe fenë e Allahut, që e kanë predikuar Profetët e Tij.

Nga metodat më të vjetra dhe më të përhapura, të cilat njëkohësisht janë nga

¹ Sundues në kohën e Profetit Ibrahim, shiko Sure Bekare, 258.

² Lexo suren Taha, 49-72.

më lajkataret dhe tinëzaret është edhe akuzat ndaj fesë së Allahut, duke u hequr si këshillues, si dashamirës e miqësor. Këtë metodë e përdorën kurejshët me fiset dhe njerëzit përreth, të cilët nuk e njihnin Muhamedin dhe Fenë Islame. Ata e akuzuan Muhamedin, si magjistar, i çmendur dhe poet, aq sa dikush vendosi në veshët e tij pambuk, në mënyrë që të mos dëgjonte ndonjë fjalë të këtij njeriu, por kur përballej me të dhe dëgjonte prej tij, e kuptonte fare mirë, se e gjitha kjo kish qenë një truk dhe një iluzion, në mënyrë që t'i mbante ata peng të së kotës dhe larg të vërtetës. **“Thuaj: “E vërteta erdhi, kurse e pavërteta është fshirë e nuk mund të shfaqet përsëri”.**⁴

E njëjta situatë përsëritet edhe sot. Dashakeqët e Islamit dhe të muslimanëve, të cilët njëkohësisht zotërojnë pjesën dërmuese të medias së shkruar dhe vizive, kanë kohë që hedhin akuza të njëpasnjëshme ndaj Islamit dhe muslimanëve. Një gjë e tillë prej tyre është e pritshme, sepse ata kërkojnë që me anë të saj të ulin potencialin e Islamit, i cili po përhapet fuqishëm në mesin e tyre (në përfundim), ndaj dhe mjeti më i mirë për parandalimin e këtij fenomeni është hedhja baltë mbi Fenë Islame dhe pasuesit e saj. **“Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e**

“...Duhet të pohojmë se të vrrarët në radhët e kundërshtarëve të Muhamedit dhe fesë së tij përgjatë njëzet e tre vjetëve të jetës së tij, nuk e kalonin numrin e fëmijëve të vrrarë nga krimet çifute kundra Gazës vitin e shkuar...”

çështjeve”.⁵

Sot përfundimi i krishterë për të arritur qëllimet e tij, po hedh mbi Islamit akuzat më të rënda, ndaj Profetit të tij, akuzat më të paqena dhe ndaj Kuranit shpifjet më të ulëta. Karikaturat nëpër gazetatat famëkeqe të Danimarkës dhe Evropës mbarë, ende vazhdojnë dhe nxisin incidente dhe zemërim. Ata mundohen të shpalesin se Muhamedi, Profeti Islam ka qenë një njeri, i cili nxiste vetëm luftëra dhe ishte i etur për gjakderdhje. Ata e dinë se janë duke gënjyer, sepse ata e njohin më mirë se kushdo tjetër personalitetin e Profetit tonë: **“Atyre që u kemi dhënë Librin, e njohin atë (Profetin), ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë”.**⁶ Por këto akuza që ata hedhin, janë ndoshta nga masat e vetme për t'i mbajtur njerëzit në errësirë dhe padituri rreth realitetit të Fesë Islame, ashtu sikurse bënin në

³ Lexo suren Nuh.

⁴ Sure, Sebe: 49.

⁵ Sure Ali Imran, 186.

⁶ Sure Bekare, 146.

Mesjetë me mendimtarët e tyre, duke i djegur në turrat e druve.

Ramamakrishna Rao në lidhje me Muhamedin thotë: “Trajtimi që ai u ka bërë armiqve të vet më të egër është shembulli më fisnik për ndjekësit e tij. Gjatë çlirimit të Mekës, ai qe’ në kulmin e pushtetit të tij. Qyteti që nuk kish dashur t’ia dinte për predikimet e tij, që i kishte torturuar ndjekësit e tij, që e kishte dëbuar dhe e kishte detyruar të mërgonte bashkë me popullin e vet, dhe që e kishte persekutuar dhe bojkotuar edhe në vendin, ku ai kishte mërguar rreth 200 milje larg, tashmë shtrihej nën këmbët e tij. Sipas ligjeve të luftës ai mund të ishte hakmarrë me të drejtë për të gjitha mizoritë, që kishte hequr ai dhe njerëzit e tij. Por çfarë trajtimi u dha ai atyre? Zemra e Muhamedit ishte plot me dashuri dhe ai deklaroi: *“Në këtë ditë nuk ka HAKMARRJE ndaj jush dhe ju jeni të gjithë të lirë”*.

Duhet të pohojmë se të vrarët në radhët e kundërshtarëve të Muhamedit dhe fesë së tij⁷ përgjatë njëzet e tre vjetëve të jetës së tij, nuk e kalonin numrin e fëmijëve të vrarë nga krimet çifute kundra Gazës vitin e shkuar. Ndaj dhe me të drejtë Hjuston Smith, kur flet për figurën e Profetit thotë: “(Muhamedi) Ishte i sinqertë dhe i dashur për njerëzit e vet, njeri bujar dhe i dhembshur. Gjithnjë ka ndier dhembje ndaj vuajtjeve njerëzore dhe tregohej i gatshëm t’i ndihmonte të tjerët, e veçanërisht të varfërve dhe të paafteve. Për shkak të ndjenjës së tij të ndershmërisë, obligimit dhe të besimit, ai

“...Ndaj dhe përhapja në masë dhe e shpejtë e Islamit, nuk ka ardhur si rezultat i përdorimit të forcës e dhunës, madje as nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme të predikuesve muslimanë, përkundrazi kjo përhapje e Islamit ka ardhur për shkak të këtij libri...”

fitoi tituj të lartë si ‘i drejti’ dhe ‘i besueshmi’⁸.

E pra, ata që hedhin baltë mbi figurën e Profetit Muhamed sot janë të ndërgjegjshëm, se ai ka qenë njeriu më i mëshirshëm, që ka ecur ndonjëherë mbi shpinën e kësaj toke, se ka qenë njeriu më paqësor, më bujar, më dashamirës dhe më zemërgjeri, ashtu sikurse e dinin dhe kurejshët, se ai ishte besnik, i drejtë, bujar dhe i dashur, e megjithatë të dyja palët, si të djeshmit dhe të sotmit kanë bërë plane, që me anë të këtyre akuzave të mbajnë larg njerëzit nga Islami dhe asgjë më tepër.

Akuzat e tyre nuk u kufizuan vetëm me figurën e Profetit të mëshirës, por ata fyen, shanë e përdhosën edhe Kuranin, librin e Allahut të Lartësuar. Me këtë lloj politike qarqe të caktuara në Perëndim, mundohen të mbjellin ndër masat e njerëzve idetë, se

⁷ Të cilët vazhdimisht provokonin luftëra dhe që kërkonin të zhduknin fizikisht, vetë Muhamedin dhe fenë e tij.

⁸ “The Religions of Man”, Mentor Books, f. 203.

Kurani është libër që mbjell terror dhe dhunë, dhe se njerëzit nuk duhet ta mbajnë në duar këtë libër! Nga ana tjetër ne çdo ditë shohim në Perëndim forma të ndryshme të përdhosjes ndaj Kuranit. Shkaku që i shtyn ata ta bëjnë një gjë të tillë është shumë i qartë dhe tejet i lexueshëm, ata kanë frikë se nëse njerëzit do ta lexojnë këtë libër do të zbulohen shumë nga të parlat e ndyra të qarqeve të Perëndimit.

Po, ata përdhosin Kuranin, sepse e kuptojnë dhe janë të vetëdijshëm, se ai i çliron njerëzit nga prangat e robërisë, për tek krenaria. Kurani është vërtet ashtu sikurse e ka përshkruar U. Durant⁹, i cili thotë: “Kurani vazhdon që prej katërmëdhjetë shekujve të qëndrojë i ruajtur në memorien e muslimanëve. Ai ngacmon imagjinatën e tyre, u modelon sjelljet dhe nxit natyrat e miliona njerëzve. Kurani u përçon shpirtave besimin e thjeshtë, larg mjegullimeve, dokeve dhe liturgjive, madje mesazhet e tij më të shumta janë për çlirimin nga idhujtaria. Ai ka meritën më të madhe të ngritjes së nivelit të muslimanëve në aspektin e moralit dhe të kulturës. Ai ka ngritur tek ata rregullat e shoqërisë, i ka çliruar mendjet e tyre nga shumë iluzione dhe supersticione; i ka çliruar nga padrejtësia dhe egërsia, madje nëpërmjet tij u lehtësua gjendja e skllëvërve. Ai mbolli në shpirtat e të përçmuarve krenarinë dhe mbolli mes muslimanëve

“Kur një musliman lëshon mjekër, menjëherë do të mendohet apo akuzohet si ekstremist e vehabi, ndërsa kur lëshojnë hebrenjtë mjekra, ata nuk quhen të tillë, por nderohen si njerëz fetarë?!...”

drejtësinë, përqendrimin dhe largimin nga epshet në një mënyrë, aq të përkryer, sa nuk mund të gjesh një shembull si ai në ndonjë cep toke ku jetojnë të bardhët”.¹⁰

Ndërsa J. S. Restler¹¹ shprehet: “Kurani ka aftësinë të gjejë zgjidhje për të gjitha problemet, ai bën një lidhje të përkryer mes ligjit fetar dhe atij moral. Ai përpiqet për ngritjen e rregullit, unitetin e shoqërisë dhe pakësimin e mjerimit. Kurani përpiqet për ndihmesën e të dobëtëve, këshillon për bamirësi dhe urdhëron për mëshirë”.¹²

Ndaj dhe përhapja në masë dhe e shpejtë e Islamit, nuk ka ardhur si rezultat i përdorimit të forcës e dhunës, madje as nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme të predikuesve muslimanë, përkundrazi kjo përhapje e Islamit ka ardhur për shkak të këtij libri; Librit të Allahut e fjalës së vërtetë, të cilin muslimanët ia paraqitën

⁹U. Durant është shkrimtar bashkëkohor amerikan, libri i tij “Historia e civilizimit” konsiderohet ndër librat më të shquar që flasin për civilizimin e popujve.

V Historia e civilizimit, v: 16, fq: 68-69.

¹¹J. S. Restler është një studiues francez bashkëkohor.

¹²Civilizimi arab fq. 45.

popujve të mundur, duke i lënë të zgjedhin mes leximit dhe refuzimit të tij”.¹³

Këto mesazhe janë të qarta dhe hedhin dritë ende më tepër për shkaqet e kësaj lufte barbare me shpifje ndaj Islamit. Prapavija e tyre është një: Të parandalojmë sa të mundemi përhapjen e Islamit. Në momentet që shahen përdhosen dhe hidhet shpifje për simbolet më madhore të fesë Islame, natyrshëm nuk do të mbeten jashtë kornizave të shpifjes besimtarët muslimanë, të cilët mundohen të praktikojnë fenë e tyre. Aq shumë janë tepruar shpifjet ndaj muslimanëve, sa që kur një femër muslimane shfaqet e mbuluar, menjëherë mendohet se ajo është e detyruar, e dhunuar, e persekutuar, e prapambetur etj., ndërsa nëse mbulohet një e krishtere, ajo shihet si grua e denjë dhe respektohet në maksimum si një shërbëto e fesë së saj?!

Kur një musliman lëshon mjekër, menjëherë do të mendohet apo akuzohet si ekstremist e vehabi, ndërsa kur lëshojnë hebrenjtë mjekra, ata nuk quhen të tillë, por nderohen si njerëz fetarë?!

Në momentin kur një musliman i papërgjegjshëm bën një krim, që bie ndesh me parimet e Islamit, menjëherë në kafazin e të akuzuarve gjendet vetëm Islami, ndërsa kur të krishterët dhe hebrenjtë ndërmarrin shfarosjen e popujve në emër të fesë, në këto situata feja nuk përmendet sepse e tillë është politika?! Sado që Perëndimi me propagandën e tij mediatike të hedhë

■ Ky është pikërisht një tekst i përpiktë i studiueses Italgjane Laura Veccia Vaglieri, të cilin e ka përmendur në librin e saj: “Në mbrojtje të Islamit”, fq: 59.

¹⁴ Sure Hashër, 8-9.

akuza të paqena për Islamin, Kuranin dhe muslimanët, përsëri njerëzit që zotërojnë logjikë të shëndoshë e dinë dhe janë të ndërgjegjshëm, se burgjet e inkuizicionit, Guantanamo, Ebu Graibit, përdhunimin e grave dhe të miturve, vrasjen e civilëve dhe pushtimin e shteteve (vetëm për fitime materiale) në emër të lirisë, nuk i kanë ndërmarrë muslimanët, nuk i kanë nxitur Kurani, Muhamedi e as Islami, porse vetëm njerëz famëkëqij, të cilët historia dhe njerëzimi do t’i kujtojë si kriminelë lufte. Madje edhe shumë krime, të cilat ua veshin muslimanëve, nuk janë gjë tjetër vetëm se një hallkë në zinxhirin e madh të shpifjeve ndaj kësaj feje dhe pasuesve të saj, të cilat nuk është e vështirë për shërbimet sekrete t’i realizojnë vetë ato.

Ata përpiqen që të parandalojnë përhapjen e kësaj feje, përpiqen të shuajnë dritën e Allahut me akuzat dhe luftën e tyre, me shpifje të paqena dhe jo reale, por nuk do të mundën dot t’ia arrijnë këtij qëllimi, sepse Allahu do ta plotësojë fenë e Tij, edhe pse nuk i vjen mirë jobesimtarëve. ***“Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët. Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët”.*** ■

DAJAK APO EDUKIM PËR GRUAN?!

Natyrë e jetës është që mund të çojë drejt mospajtitimit dhe grindjeve. Por kjo nuk do të thotë që burri të përdorë dhunën në zgjidhjen e këtij problemi, apo të shkëpusë lidhjen martesore për gjënë më të vogël dhe për shkaqe nga më të lehtat.

PËRGATITI: RASHIT ZYLFIU

Urtësia dhe vullneti i Allahut i ka paraprirë njerëzve, që lidhja martesore të jetë koncepti i ndërtimit të këtij universi. Allahu i Madhëruar thotë: *“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!”*¹

Kështu u krijua njerëzimi nga ata edhe çiftet, ku nëpërmjet tyre plotësohet ruajtja e kësaj krijese dhe vazhdimësia në këtë jetë. Të jetë mëkëmbës në tokë në pëlqim me ligjin e Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë *“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”*² As jeta njerëzore, as shoqëria njerëzore nuk mund të ketë stabilitet përderisa të mos ketë një koncept të qartë në lidhje me çiftin martesor dhe përcaktimin e pozicionit të çdonjërit prej tyre në këtë jetë.

Koncepti islam mbi gruan:

Islami ka treguar një kujdes të veçantë në përmirësimin e gruas dhe lidhjeve mes çifteve mbi baza të natyrshmërisë që Allahu ka futur në këtë krijesë. Si dhe në anën e barazisë në aspektin njerëzor dhe të ndershmërinë njerëzore, që duhet të zotërojë krijesa njeri, qoftë mashkull apo femër.

Allahu i Madhëruar thotë: *“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, që ju krijoi juve prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra.”*³

Një kujdes të veçantë të barazisë mes çifteve e kemi edhe në raportet me krijuesin dhe shpërblimet tek Ai. *“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër.”*⁴

Allahu i Madhëruar e ka krijuar çiftin njerëzor në përputhje me punët, që ata janë të ngarkuar në këtë jetë, që të anojnë dhe të tërheqin njëri-tjetrin. Islami këtë lidhje, apo bashkim e rregulloi duke mos e lënë që të jetë rrëmujë apo të ushtrohet dhunë, as nën

¹ Jasin, 36

² Rrum, 21

³ Nisa, 1

⁴ Ali Imran, 195

“Disa muslimanë, që nuk kanë kuptim të drejtë mbi Islamin ushtrojnë dhunë me pretekstin, se Islami e ka lejuar rrahjen e gruas dhe kështu thyejnë çdo normë njerëzore dhe fetare...”

rregullat e lidhjeve dhe komunikimit mes anëtarëve të saj për realizimin e drejtësisë dhe të vërtetës. Allahu i Madhëruar urdhëron e thotë: **“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi...”**⁵

Të gjithë këtë e ka lidhur me besimin dhe ka bërë që devotshmëria të jetë siguri në përmbajtjen e këtyre detyrimeve, të punohet me to dhe mos të thyhet ky rregull, dhe secili prej tyre duhet të zbatojë këtë për veten e vet para se të kërkojë të drejtë prej tjetrit, duke qëndruar kështu larg nga padrejtësia dhe mizoria. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kini frikë Allahun dhe ta dini se Allahu është i Dijshëm për çdo gjë!”**

Familja është e patjetërsueshme në bazë të natyrshmërisë psikologjike dhe sociale:

Rregulli familjar është diçka e patjetërsueshme, që e kërkon natyrshmëria dhe nevoja shpirtërore e thellë e njeriut, gjë të cilën nuk e gjejmë tek gjallesat të tjera. Për këtë Islami e ka lartësuar pozitën e familjes dhe ka treguar një interes shumë të madh: në themelimin e saj, në përkujdesjen dhe mbikëqyrjen pasi të krijohet ajo. Për këtë ka legjitimuar dispozita të forta, të

mëshirën e nepsit që shpije çdo herë tek e keqja, as të emocioneve të pakontrolluara, e as të jenë pre’ e epshit të egër. Islami e legjitimoi martesën për plotësimin e nevojave trupore, shpirtërore tek të dy pjesëtarët e çiftit, ku çdonjëri ka nevojë për tjetrin. Kjo është natyrshmëria e krijimit, ashtu si ka nevojë njeriu për veshje që të mbulohet dhe të ruhet nga ndikimet e motit, ose nevoja për të gjetur strehim diku. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato.”**

Islami kujdeset për t’i sqaruar të drejtat dhe detyrimet mes anëtarëve të familjes,

⁵ Bekare, 187

⁶ Bekare, 228

⁷ Bekare, 231

sakta për ruajtjen e unitetit dhe mosshembjen e saj. Pastaj u përkujdes për vendosjen e masave të ndryshme, që parandalojnë çarjen e saj.

Në rastet kur ndodhin stuhi dhe goditet ajo, atëherë premtimi duhet të çohet në vend që kësaj shtylle të shoqërisë t'i gjendet ilaçi i suksesshëm pas një diagnoze të saktë të sëmundjes, e cila e ka çuar atë deri në atë gjendje, dhe njohjes së shkaqeve të devijimit, që e largon nga stabiliteti dhe serioziteti drejt lëkundjes së shtyllave të saj.

Realiteti dhe idealizimi në sistemin e familjes:

Feja islame edhe pse vazhdimisht i thërret njerëzit drejt idealeve dhe përkryerjes në një shkallë të lartë, ai po ashtu nuk e anashkalon anën e dobësisë dhe të devijimit, që mund të ndodhë në çdo aspekt të jetës, por edhe në atë të sistemit familjar. Nga ky realitet, që Islami nuk e anashkalon është edhe ajo që mund të ndodhë, si mospajtimi apo sjelljet e këqija mes dy çifteve. Natyra e jetës është që mund të çojë drejt mospajtimit dhe grindjeve. Por kjo nuk do të thotë që burri të përdorë dhunën në zgjidhjen e këtij problemi, apo të shkëpusë lidhjen martesore për gjënë më të vogël dhe për shkaqe nga më të lehtat. Për këtë burrit i ndalohet, që mos të ngutet në prishjen e kësaj lidhje. Islami e ka bërë divorcin gjënë më të urryer. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Gjëja më e urryer e lejuar tek Allahu është divorci”**.

Gjithashtu, e ka ndaluar gruan të kërkojë divorc pa arsye. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Çdo grua që kërkon nga burri i saj divorc pa arsye, e ka të ndaluar ta shijojë erën e xhenetit.”**⁸

⁸ Shënuar nga: Ebu Davudi, Ibën Maxhe dhe Hakimi në Mustedrekun e tij dhe ka thënë se është i vërtetë sipas kushteve të Muslimit.

⁹ Shënuar nga Ebu Davudi, Termidhiu.

¹⁰ Shënon Taberaniu.

¹¹ Nisa, 34

“...Atai thotë: e kam pyetur Ibën Abasin: Çfarë është rrahja pa lëndime? Ai ka thënë: Rrahja të bëhet me misvak...”

Ka ndaluar prishjen reciproke mes çifteve dhe e ka klasifikuar këtë nga mëkatet më të mëdha. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Kush i prish lidhjet e gruas me burrin e saj, nuk është nga ne.”**¹⁰

Islami projektton skicën e masave të sigurta në parandalimin e dhunës së mundshme në raste mospajtimi. Çiftet duhen t'i përmbahen kësaj skice për mënjanimin e mospajtimeve dhe marrjen e ilaçit të suksesshëm për kthimin në gjendje normale të familjes .

Masat parandaluese për të penguar çarjen:

Islami bën një skicim për burrin, për shërimin e marrëdhënieve në rast se ai i druhet mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga gruaja e tij, e cila mund të ndikojë në shtëpi apo organizmin familjar dhe bashkësinë shoqërore, apo në rrëzimin e saj dhe kjo arrihet me tre masa edukative të shkallëzuara: ideologjike, psikologjike dhe materiale. Allahu i Madhëruar thotë: **“Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini, (e nëse kjo s'bën dobi) mos i pranoni në shtrat dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas). Por nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më. Allahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar!”**¹¹

Dispozita:

Në ajetin e sipërpërmendur janë të cekur tre masa parandaluese, ku pas këtyre vijnë edhe dy të fundit, njëra është alarmi për divorce dhe e fundit ilaçi i urryer divorci.

Masa e parë është që në raste të tilla burri duhet ta këshillojë gruan, duke i përkujtuar frikën që duhet të ketë ndaj Allahut dhe respektimin e të drejtave ndaj burrit të saj. Po qe se kjo masë nuk bën dobi, atëherë nuk duhet ta pranojë gruan në shtrat. Qëllimi i ajetit kuranor “(e, nëse kjo s'bën dobi, (pra, këshilla) **mos i pranoni në shtrat**”. Ibën Kethiri përmend se qëllimi është mos bashkimi në shtrat dhe të mos kontaktosh seksualisht me gruan. Në rast se gruaja vazhdon të rebelohet ndaj burrit të saj dhe kjo masë nuk është e dobishme, atëherë burrit i lejohet ta rrahë lehtas. **“dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas)...”**. Në këtë ajet shihet qartë, se çfarë rëndësie i jep Islami ruajtjes së familjes dhe mbyll dyert për mosshkatërrimin e saj. Por shumë njerëz në mungesë të informacionit mbi Islamin qoftë nga vete muslimanët apo edhe nga jomuslimanët përdorin vetëm këtë pjesë të ajetit për t'ia ulur imazhin Islamit.

Disa muslimanë, që nuk kanë kuptim të drejtë mbi Islamin ushtrojnë dhunë me pretekstin, se Islami e ka lejuar rrahjen e gruas dhe kështu thyejnë çdo normë njerëzore dhe fetare mbi padrejtësinë, që ata ua bëjnë grave të tyre. Të tjerë, nga jo muslimanët të cilët në mungesë të informacionit të duhur për Islam, shfrytëzojnë rastin për ta sulmuar Islam me pretekstin, se Islami ushtron dhunë mbi gruan, duke mbledhur fonde, hapur organizata të ndryshme dhe mbajtur konferenca të ndryshme madje edhe në vendet muslimane për ta ruajtur gruan nga dhuna.

■
¹² Nisa, 35.

Por çfarë fshihet pas kësaj rrahje të lehtë?

Nëse hapen të gjitha librat që komentojnë Kuranin Famëlartë do të shohim, se qëllimi i kësaj rrahje të lehtë është edukative e nuk ka si qëllim dhunën apo lëndimin.

Ibën Kethiri thotë se nëse këshilla dhe largimi nga shtrati nuk bëjnë dobi, atëherë rrihni me një rrahje të lehtë, që nuk lëndon. Këtë mendim e mbështet Ibën Abasi dhe të tjerët. Hasan Basriu thotë: Qëllimi është: që mos të lërë gjurmë. Fukahatë thonë: Nuk guxon të thyhet ndonjë gjymtyrë e as të lërë gjurmë. Atai thotë: e kam pyetur Ibën Abasin: Çfarë është rrahja pa lëndime? Ai ka thënë: Rrahja të bëhet me misvak.

Nëse kjo është qëllim si parandalim për mos ardhjen deri te divorci e ajo është t'i mbështetesh një gjykate familjare nga familjet e të dy palëve, për rregullimin e raporteve dhe largimin e shkaqeve të çarjes me gjykimin e njerëzve, që janë besnikë nga të afërmit e çifteve. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmyetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim, Allahu sjell marrëveshje midis tyre. Allahu, me të vërtetë, është i Gjithëdijshëm dhe i di të gjitha qëllimet.”**¹²

Atëherë si mundet dikush, që në emër të kësaj rrahje edukative të ushtrojë dhunë, e dikush ta sulmojë Islam, se është fe e dhunës.

Po qe se këto masa parandaluese për të penguar çarjen nuk kanë sukses dhe vazhdon mospajtimi dhe prishja, atëherë nuk ka problem që t'i ktheheni divorcit, si ilaç i urryer për këtë gjendje. ■



RRINI LARG NESH, O NJERËZ TË DHUNËS

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ue selem dhe sahabet pas tij u mbështetën tek gratë në çështjet e infermierisë dhe mjekësisë. Nga mesi i atyre grave kishte tregtare, poete dhe dijetare, në një kohë kur për romakët gruaja shitej kur martohej, sipas të ashtuquajturës “marrëveshja e sundimit”, ndërsa në legjislacionin “Mano” të indianëve të vjetër thuhej: “Vdekja, ferri, helmi, gjarpërinjtë dhe zjarri nuk janë më të këqij se gruaja.”

DR. DEJMA TAHBUB

Më datë 25 Nëntor bota përkujtoi Ditën Ndërkombëtare të Luftës kundër Dhunës ndaj Gruas. Kjo është një ditë simbolike, të cilën e kanë specifikuar Kombet e Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare për të sjellë në qendër të vëmendjes - qoftë edhe vetëm nga ana mediatike - problematikat e gruas dhe

rreziqet që e rrethojnë atë. Kjo ditë, ashtu si dhe të gjitha ditët e tjera të përcaktuara për njerëzimin, për grupe të veçanta, për fëmijët, pemët, tokën etj., është një ditë si ditët e tjera të shumta të përcaktuara të vitit, prej të cilave njerëzit që janë vënë në qendër të vëmendjes nuk përfitojnë gjë tjetër përveç deklaratave të parfumuara dhe falënderimeve gojore, ndërkohë që të drejtat e tyre mbeten ende të shtypura, siç janë punëtorët, apo nderi i tyre mbetet

“Ata e përkufizojnë dhunën ashtu si dëshirojnë dhe harrojnë se shtëpitë e tyre i kanë prej qelqi dhe dhuna po mbyllet shoqëritë e tyre. Disa statistika tregojnë se 59% të femijëve francezë lindin jashtë martese...”

ende i përdhosur, siç janë gratë. Po kështu edhe pushtimi i pashpirt ushtarak, ideologjik dhe ekonomik mbetet ende i pranishëm në pjesën më të madhe të vendeve tona, ndërkohë që ata që festojnë thërrasin me të madhe: “Me gjak dhe me shpirt do të të mbrojmë!...”

Ditë të tëra janë të shënuara nga marrëveshje ndërkombëtare, karta të të drejtave të njeriut dhe ndërmjet festimeve zyrtare kalojnë muaj të tejzgjatur të mbushur me sjellje brutale dhe uzurpim.

Të drejtat që kërkojnë ditët hidhen tej prej sjelljeve krejt të kundërta përgjatë vitit. Ajo që mbjell kultura e përkohshme çdo ditë, çdo orë, çdo minutë heshtjeje, çdo sadaka me qindarka apo çdo sjellje që tregon respekt, nuk mund të sjellë fryte përveç se nëpërmjet një sjelljeje të përhershme, që ka nevojë për një edukim social, ndjesi individuale, kontroll institucional, në mënyrë që këto ditë të kenë një ngjyrë të përhershme dhe të kalojnë nga prodhimi i teorive drejt praktikës dhe zbatimit.

Në këtë rast duhet të theksojmë sesi ka arritur Islami përpara ligjeve njerëzore të realizojë një nivel të lartë të

individualitetit femëror, që ia kalon legjislacioneve të tjera, duke e ditur nga Ligjvënësi i Lartësuar, se njerëzimi do ta ketë në vazhdimësi tendencën për ta dobësuar pozitën e gruas. Për këtë arsye Ligjvënësi e ka ngritur lart peshën e tyre në suren Nisa (kaptina e grave), e cila mbron të drejtat e tyre materiale dhe shpirtërore. I Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* i edukonte vazhdimisht sahabet, që të silleshin mirë me gratë dhe u sillte atyre në vëmendje, se më fisniku ndër ta ishte ai që i respektonte ato dhe më mosmirënjohësi ndër ta ishte ai që i poshtëronte ato.

Gjithashtu i Dërguari Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* e ngriti lart pozitën e grave, duke i bërë ato një nga shkaqet e plotësimit të fesë: “*Kur robi martohet, gjysma e fesë së tij është plotësuar dhe le t'i frikësohet Allahut për gjysmën tjetër.*” Profeti e ngre edhe më lart pozitën e grave, kur i konsideron ato si një nga thesaret më të mira të dynjasë: “*Një zemër falënderuese, një gjuhë që përkujton Allahun dhe një grua e mirë do të të ndihmojnë në çështjet e dynjasë dhe të fesë. Këto janë thesaret më të mira të njerëzve.*”

I Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe sahabet pas tij u mbështetën tek gratë në çështjet e infermierisë dhe mjekësisë. Nga mesi i atyre grave kishte tregtare, poete dhe dijetare, në një kohë kur për romakët gruaja shitej kur martohet, sipas të ashtuquajturës “marrëveshja e sundimit”, ndërsa në legjislacionin “Mano” të indianëve të vjetër thuhej: “Vdekja, ferri, helmi, gjarpërinjtë dhe zjarri nuk janë më të këqij se gruaja.”

Ky është Islami, ku robi nëse pajiset me edukatën e tij, këto ditë bëhen që të gjitha ditë të gruas, sjellja e mirë me të bëhet

adhurim, ndërsa drejtësia mes saj dhe burrit është ligj në thënien e Allahut të Lartësuar: ***“Kush bën vepra të mira, mashkull apo femër duke qenë besimtar, atij do t’i ngjallim një jetë të mirë.”*** Lavdërimi i saj vjen prej Zotit të njerëzimit përpara vetë njerëzimit, ashtu siç ndodhi me sahabijen Havlen, të bijën e Thalebesë, kur erdhi që të ankohej për burrin e saj, që e konsideroi atë si nënën e vet, edhe pse ajo gjatë gjithë jetës kishte edukuar fëmijët e tij dhe ishte kujdesur për të.

Ky është Islami që i ka dhënë gruas të gjithë të drejtat e plota, të drejtat e një qytetari të pacenuar, një pavarësi materiale dhe shpirtërore, një liri në shprehjen e mendimit edhe në çështjet me të thella të privatësisë së saj, siç është martesja dhe në çështjet madhore që i përkasin asaj, si vetëveprimi me pasurinë e saj.

Por jo pretenduesit e lirisë, që na mburren për lirinë që vjen së bashku me autokolonat e tankeve dhe oshtimën e plumbave. Kjo është liria që cenon nderin, që djeg viktimën, që fsheh krimin dhe pastaj jep vendimin me burg për kriminelin, që del nga burgu pas disa vitesh për sjellje të mirë, ose nderohet dhe respektohet?! Kurse viktima nuk di asgjë për dënimin, nëse ndodh, nuk i shërohen plagët dhe as nuk i kthehet nderi as pas një dite, as pas disa ditësh dhe as pas disa vitesh.

Na akuzojnë për dhunë dhe na shohin si popuj që kemi nevojë të edukohemi dhe të arsimohemi, ndërkohë që i privojnë qytetarët e tyre gra të arsimohen, të punojnë apo që të kontribuojnë pozitivisht në jetë, për shkak se ato veshin shaminë, apo sepse zbatojnë dispozitat e fesë së tyre. Ata e përkufizojnë dhunën ashtu si dëshirojnë dhe harrojnë se shtëpitë e tyre i kanë prej qelqi dhe dhuna po mby

“Por ata shohin qimet në syrin tonë dhe nuk e shohin traun në syrin e tyre. Përse nuk përpiqen për nderin e grave të tyre përpara se të shqetësohen për nderin e grave tona?!...”

shoqëritë e tyre. Disa statistika tregojnë se 59% të fëmijëve francezë lindin jashtë martese, se numri i të martuarve në Britani nuk i kalon 50.3%, se gjysmë milioni adoleshentë në Amerikë vuajnë nga sëmundje seksuale për shkak të përhapjes së pornografisë, se 20% e femrave adoleshente tentojnë vetëvrasjen të paktën një herë në vit dhe se 21% grave në SHBA ekspozohen ndaj përdhunimit. Amerika është vendi i parë në botë për sa i përket rasteve të përdhunimit, 25% e grave britanike janë të ekspozuara ndaj dhunës dhe policia merr rreth njëqindmijë telefonata për dhunë në vit.

A nuk përfaqësojnë këto përqindje një cenim të madh dhe një dhunë të ashpër ndaj gruas, qoftë si nënë, si vajzë, si motër dhe si bashkëshorte? Por kush i kërkon llogari atyre për gratë e tyre dhe për gratë tona? Kush mund të hedhë dritë mbi krimet e tyre përpara se të bien daullet për krimet tona të pakta dhe të papranueshme? Por ata shohin qimet në syrin tonë dhe nuk e shohin traun në syrin e tyre. Përse nuk përpiqen për nderin e grave të tyre përpara se të shqetësohen për nderin e grave tona?! ■

nga arabishtja: Genc PLUMBI



Ekra ibën Habisi e ka parë Resulullahun sal-lallahu alejhi ue selem duke puthur nipin e tij Hasanin dhe i kishte thënë, se ai kishte njëmbëdhjetë fëmijë, por asnjërin prej tyre nuk e kishte puthur asnjëherë. Në këtë rast Resulullahu sal-lallahu alejhi ue selem shpalosi një platformë, e cila vlen për çdo edukator, kur tha: “Kush nuk mëshiron nuk mëshirohet.”

O PRINDËR, KU I KENI KËTO CILËSI?!

AMIR MUHAMED

Prindi për të krijuar një familje të shëndoshë dhe progresive duhet doemos të stoliset me disa cilësi që e ndihmojnë procesin e edukimit të tyre. Ndër to, ne do t'i veçojmë disa në këtë shkrim të shkurtër:

1. Shëmbëlltyra

Shëmbëlltyra konsiderohet prej cilësive më me rëndësi në edukimin e fëmijëve. Këtij elementi selefët i kanë kushtuar një kujdes të madh. Për ta vërtetuar këtë po ju përmend një rast kur Amër ibën Utbe e porositi edukatorin e fëmijëve të tij duke i thënë: Fillimisht përmirëso veten e pastaj fillo me fëmijët, sepse sytë e tyre janë të lidhur me syrin tënd. E mirë tek ata është ajo që vepron ti, kurse e ligë tek ata është ajo që e len ti. Pra, fëmijët nuk janë në gjendje t'i kuptojnë gjërat vetë e as me të dëgjuar, kur jua thua me gojë. Ata kanë nevojë për një shëmbëlltyrë e ajo shëmbëlltyrë është prindi.

2-Dashuria dhe mëshira

Na përcillet nga Abdullah ibën Amër radijallahu anhuma, se Resulullahu sal-lallahu alejhi ue selem ka thënë: “Nuk është nga ne ai që nuk i mëshiron fëmijët dhe nuk i respekton të mëdhenjtë.”

Na përcillet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu, se Ekra ibën Habisi e ka parë Resulullahun sal-lallahu alejhi ue selem duke puthur nipin e tij Hasanin dhe i kishte thënë, se ai kishte njëmbëdhjetë fëmijë, por asnjërin prej tyre nuk e kishte puthur asnjëherë. Në këtë rast Resulullahu sal-lallahu alejhi ue selem shpalosi një platformë, e cila vlen për çdo edukator, kur tha: “Kush nuk mëshiron nuk mëshirohet.”

Pra, Resulullahu sal-lallahu alejhi ue selem puthjen e fëmijëve e konsideronte mëshirë për ta. Një dukuri të tillë duhet ta kultivojë çdo prind dhe edukator, sepse është metodologji profetike për edukimin e tyre.

“Fillimisht përmirëso veten e pastaj fillo me fëmijët, sepse sytë e tyre janë të lidhur me syrin tënd. E mirë tek ata është ajo që vepron ti, kurse e ligë tek ata është ajo që e len ti...”

3-Drejtësia

Resulullahu *sal-lallahu alejhi ue selem* na ka urdhëruar që të tregohemi të drejtë mes fëmijëve, kur t'u japim atyre diçka, ai thotë: “Kur t'u jepni atyre, jini të drejtë.”

Kur është në pyetje drejtësia mes fëmijëve prindi duhet të jetë shumë vigjilent dhe i kujdesshëm ndaj tyre, duke mos lënë hapësirë, që të krijohet zilia dhe urrejtja mes tyre, sepse një gjë e tillë mund të ndikojë negativisht në edukimin e tyre.

4-Përzierja me ta

Çdo besimtar është i detyruar ta ndjekë Resulullahun *sal-lallahu alejhi ue selem* në çdo aspekt. Prandaj edhe prindi duhet të sillet me fëmijët e vet, ashtu si ka vepruar Resulullahu *sal-lallahu alejhi ue selem* me fëmijët dhe nipat e tij. Sahabet na përcjellin, se Resulullahu i merrte në krah Hasanin dhe Husejnin e nganjëherë ata i hipnin në shpinë e ai lozte me ta, por ka pasur edhe raste kur ata kanë qenë në krahun e Resulullahut *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe e kanë kryer edhe nevojën e tyre. Ai vepronte kështu, që njerëzit ta ndjekin atë dhe ta kuptojnë, se një lëvizje e tillë e ndihmon procesin e edukimit të fëmijës.

5-Urtësia në këshilla

Prindi duhet të jetë shumë vigjilent, kur e edukon fëmijën e vet. Ai duhet të përdorë një

metodologji, e cila nuk krijon urrejtje mes prindit dhe fëmijës. Kjo mund të arrihet atëherë kur prindi i jep fëmijës liri, por pa i tejkaluar kufijtë. Ai nuk duhet të tregohet shumë rigoroz në praktikimin e rregullit shtëpiak e as shumë tolerant, por të gjejë një mesatare, si dhe të mos kërkojë detyrime prej fëmijëve, të cilat janë për të mëdhenjtë, derisa fëmija të jetë në moshën e vogël.

6-Lutja

Duhet të dimë se lutja e prindit për fëmijën e tij është e pranuar. Lutja e prindit për fëmijën e vet është edhe adhurim. Pra, prindi asnjëherë nuk duhet ta ndalë lutjen për fëmijët e vet. Këtë mund ta kuptojmë duke lexuar Kuranin Famëlartë, ku shohim se edhe pejgamberët e Allahut subhanehu ue teala janë lutur për pasardhësit e tyre. Në suren Ibrahim, Allahu subhanehu ue teala thotë: “*Kur Ibrahim tha: Zoti im! bëje këtë qytet të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.*” Ibrahim 35.

Rastin tjetër e kemi kur Zekerija *alejhi selem* i lutej Allahut *subhanehu ue teala*, që t'i japë pasardhës të mirë, duke thënë: “*Zoti im më fal mua nga ana juaj një pasardhës të mirë, me të vërtet ti je dëgjues i lutjes!*” Ali Imran 38.

Një njeri erdhi tek Abdullah ibën Mubareku dhe iu ankua për fëmijën e vet. Abdullah ibën Mubareku i tha: “A je lutur ndonjëherë për atë.” Ai tha jo. Abdullah ibën Mubareku i tha: “Ti vetë je bërë shkak për një gjë të tillë.” Pra, prindi asnjëherë nuk duhet të jetë i pakujdesshëm ndaj lutjeve që bën, sepse Allahu *subhanehu ue teala* thotë: “*Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj meje, do të hynë në xhehenem.*” Gafir 60. ■

nga arabishtja: Enver AZIZI

LIRIA NUK ËSHTË DEMOKRACIA


Përderisa në shumë shoqëri lirinë e kufizojnë më pak ose më shumë njerëzit me idetë dhe botëkuptimet e tyre, në Islam liria përcaktohet, kultivohet, mbrohet dhe kufizohet me parimet e përgjithshme dhe të hollësishme të shpalljes hyjnore

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Fjala liri, një fjalë që si asnjë tjetër dëgjohet, kërkohet, shpresohet, luftohet për të. Një fjalë, e cila dëgjohet në çdo skaj të botës, që ngrihet lart si simbol, që synohet dhe për të cilën flijohet...

Kjo fjalë shpeshherë dëgjohet edhe nga njerëz, të cilët ndoshta nuk janë aspak të vetëdijshëm për kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Nga njerëz, bashkësi dhe popuj, të cilët ne me keqardhje konstatojmë, privohen nga liria e merituar.

Nocioni liri si koncept dhe vlerë shpeshherë keqinterpretohet dhe abuzohet. Shfrytëzohet për t'u arritur tek qëllimet e hartuara, për t'i realizuar synimet e planifikuara. Në emër të lirisë shpeshherë pengohen, shuhen



liri të shumta, madje edhe shpallen luftëra kundër popujve që çlirohen duke u privuar nga liria.

Drejtuesit e botës mundohen të na bindin, se demokracia është e vetmja mënyrë që u siguron njerëzve lirinë. Prandaj ata pretendojnë, se thirrja për demokraci në të njëjtën kohë është thirrje për liri. Në këtë kontekst dalin disa pyetje, që kërkojnë përgjigje. Demokracia e zbatuar në vendet më të zhvilluara të botës, a e siguron në plotësi lirinë e kërkuar nga njerëzit?

Cili është lloji, cilësia dhe kufiri i lirisë së ofruar nga demokracia për popujt? Qytetarët e botës së zhvilluar, a janë me të vërtetë njerëzit që më shumë se çdokush tjetër gëzojnë lirinë e proklamuar?

Konstatimi parimor, i cili duhet të kihet parasysh është se liria në kuptimin e saj absolut nuk është realitet në asnjë shoqëri njerëzore. Kufizimet e llojeve të ndryshme, që sigurojnë mbarëvajtjen e shoqërisë janë rregullatorët e funksionalitetit në të gjitha shoqëritë. Legjislacioni, traditat, zakonet janë disa nga mekanizmat, që në aspektin shoqëror mund të përkufizohen si kufizues të lirisë. Liria absolute është sinonim i anarkisë. Në modelin e demokracisë, demokracia është ajo që i vendos kufijtë e lirisë, cakton të lejuarën dhe të ndaluarën, të preferuarën dhe atë që nuk preferohet. Referenca kryesore e këtyre kufizimeve është njeriu i dobët, i kufizuar, i ndikuar nga prirjet dhe pasionet. Kjo nënkupton se liritë zgjerohen dhe tkurren varësisht nga vullneti i kufizuesit, njeriut. Ajo që sot, sipas vlerësimit momental është liri legjitime, ndoshta pas disa vitesh do të përcaktohet si krim ndaj njerëzimit, përsëri me caktim nga vullneti njerëzor. Njeriu si individ është sovran, i cili

“Prej qëllimeve parimore të Islamit është emancipimi (çlirimi) i mendjes nga besëtytnitë dhe ndjenja e varësisë nga krijesa, çlirimi i shpirtit nga mëkati dhe prishja...”

cakton interesin individual dhe atë shoqëror. Me këtë koncept popujt janë fushë testimi në të cilën ndryshojnë kuptimet e lirisë me ndryshimin e qëndrimeve që kanë ndikuesit efektivë në rrjedhën e jetës njerëzore.

Përderisa në shumë shoqëri lirinë e kufizojnë më pak ose më shumë njerëzit me idetë dhe botëkuptimet e tyre, në Islam liria përcaktohet, kultivohet, mbrohet dhe kufizohet me parimet e përgjithshme dhe të hollësishme të shpalljes hyjnore. Allahu, Krijuesi i njeriut, Ai të cilit nuk i atribuohet asnjë mangësi, dobësi dhe paaftësi, Ai i cili është i njoftuar me hollësi për gjendjen e robërve të Tij, me gjërat që u përshtaten dhe me nevojat e tyre, Ai përkufizon lirinë më të dobishme dhe që i përshtatet llojit njerëzor. Koncepti i lirisë në Islam dallohet me stabilitet dhe konsistencë, ajo që ka qenë e lejuar para më tepër se katërmbëdhjetë shekujsh është e lejuar edhe sot, dhe do të mbetet e lejuar deri në Ditën e Gjykimit.

Shpallja hyjnore e fundit e thekson lartësimin e njeriut në pozitën që ai meriton. Allahu, i Lavdëruari, njeriun e fisnikëroi me të menduarit, i siguroi furnizimin dhe të mirat dhe e dalloi nga

shumë prej krijesave të Tij: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.”** (Isra, 70)

Me ardhjen e Pejgamberit të fundit filloi era e përhapjes së lirisë, e cila ndërtohet mbi parimin e nënshtimit të plotë ndaj Allahut. Me anulimin e të gjitha padrejtësive të periudhës së injorancës njeriut i rikthye krenaria e lirisë në suazat e nënshtimit ndaj të Drejtës...

Koncepti i lirisë në Islam nënkupton, lartësimin dhe mbrojtjen e mirësive që ka njeriu e që në thelb janë dhunti e Fuqiplotit.

Prej qëllimeve parimore të Islamit është emancipimi (çlirimi) i mendjes nga besëtytnitë dhe ndjenja e varësisë nga krijesa, çlirimi i shpirtit nga mëkati dhe prishja, i ndërgjegjes nga shtypja dhe frika, i trupit nga çrregullimi dhe degjenerimi. Në Islam njeriu lind në natyrën e pastër nga çdo njollë, i pangarkuar me mëkatin e trashëguar, i barabartë me të gjithë në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve, i pastigmatizuar me ndonjë inferioritet dhe përcëim. Rruga të cilën ia trason njeriut pas lindjes Islami dallohet me vazhdimësi në nënshtim ndaj Bujarit dhe Vigjiluesit, me përpjekje që arsyeja e dhuruar të shfrytëzohet për të mirën e fesë, me kultivimin e mbikëqyrjes të pandërprerë shpirtërore, me ndërtimin e parimeve të forta morale... vetëm duke ecur në këtë rrugë do të arrihet liria dhe çlirimi final.

Vijat e trasha që vendos Islami për të kufizuar lirinë absolute (anarkinë) në Islam janë si në vijim:

- Liria e individëve dhe bashkësive nuk

duhet të rrezikojë asnjëherë rendin e përgjithshëm në shoqëri, ose t'i dëmtojë themelet e shoqërisë Islame.

- Liria e individëve dhe shoqërive nuk duhet të shkaktojë humbjen e të drejtave të përgjithshme. Kjo vetëdije është pjesë e vlerave të brendshme, që i merr në konsideratë çdo besimtar.

- Liria e askujt nuk lejohet të dhunojë lirinë e tjetrit.

Nga kjo që u përmend kuptojmë se Islami nuk pranon liri individuale, e cila është në dëm të shoqërisë. Islami është një ekuilibër mes lirive individuale dhe shoqërore. Çdo palë e merr atë sasi të lirisë që i takon.

Koncepti Islam i lirisë është çështje e besimit, urdhër solemn nga Krijuesi Suprem. Ky koncept ndërtohet mbi këto parime fundamentale:

- Njeriu në mënyrë të plotë i nënshtrohet vetëm Allahut dhe çdonjëri për veprat e tij është përgjegjës para Allahut.

- Çdo njeri ka përgjegjësi individuale për veprat që bën dhe atij i takon të vjeli frytet e veprave që ka bërë.

- Njeriut i është dhënë mundësia e zgjedhjes, e cila duhet të bazohet në mësimet e shpalljes hyjnore dhe në parimet e rezonimit të shëndoshë. Për këto zgjedhje njeriu do të japë llogari para Allahut.

Çështja e lirisë në lidhje me besimin ka rëndësi të madhe në konceptin Islam të lirisë. **“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt** (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) **dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”** (Bekare, 256)

Allahu, subhanehu ue teala, e ndaloi

“...Të siguruar janë jeta juaj, pasuria juaj, kishat dhe kryqet tuaja... kishat nuk do të mbyllen e as që do të rrënohen...”

detyrimin në fe, edhe pse realizimi i nënshtrimit të njerëzve ndaj vullnetit të Tij fetar ishte qëllimi i çdo legjislacioni që Ai shpalli. E theksoj se pranimi i së drejtës, e cila tanimë dallohet qartë nga e shtrembra, duhet të nxitet nga bindja e brendshme, nga çlirimi i shpirtit nga prangat e besimeve të kota, e jo nga imponimi dhe diktati i jashtëm. Besimi i njeriut nuk është i frytshëm, nëse nuk ndërtohet mbi bindje, vullnet dhe përkushtim. Besimi do të ishte i pakuptimtë, atëherë kur shtytësi kryesor do të ishte forca dhe detyrimi. Në një ajet tjetër Allahu, subhanehu ue teala, të vërtetën hyjnore e paraqet si fakt të pamohueshëm, ndërsa vendimin për ta ndjekur atë ia le njeriut, i cili e vendos vetë kë drejtim do të zgjedhë ai: **“Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë” Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t’u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t’ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)!”** (Kehf, 29).

Liria e besimit nënkupton edhe lirinë e rriteve fetare. Njeriut duhet t’i lejohet kryerja e rriteve fetare pa u qortuar, nënçmuar dhe kërcënuar. Pozita që gëzonin jo-muslimanët në shtetin Islam

është një prej fakteve, që vërtetojnë të drejtën tonë të krenohemi me historinë. Kur i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, arriti në Medine nënshkroi marrëveshje bashkëjetese me çifutët. Kjo marrëveshje siguronte praktikisht, se ata kanë të drejtë të besojnë dhe të kryejnë ritet e fesë së tyre në tempujt e tyre të adhurimit. Kalifët e drejtë që erdhën në krye të muslimanëve e vazhduan të njëjtë praktikë. Omer ibën Hatabi, *radijallahu anhu*, u dërgoi banorëve të Jerusalemit (Kudsit) këtë letër: “Kjo është ajo të cilën Omeri, prijësi i besimtarëve ua siguron banorëve të Iljasë. Të siguruar janë jeta juaj, pasuria juaj, kishat dhe kryqet tuaja... kishat nuk do të mbyllen e as që do të rrënohen. Asgjë prej kishave, prej pronave të kishave, prej kryqeve nuk do të dëmtohet, askush nuk do të detyrohet ta braktisë fenë e tij, askush nuk do të dëmtohet...”

Edhe të diturit e popujve të tjerë e vërtetojnë këtë drejtësi dhe shpirtmadhësi të muslimanëve. Mishad, në librin e tij “Historia e kryqëzatave” shkruan: “Islami që urdhëron për xhihad ka shprehur zemërgjerësi ndaj ithtarëve të feve tjera. Islami i ka liruar patriarkët, murgjit dhe shërbëtorët e tyre nga tatimet dhe në veçanti ka ndaluar mbytjen e murgjve për shkak të përkushtimit të tyre ndaj adhurimit. Omer ibën Hatabi nuk i dëmtoi të krishterët, kur e çliroi Jerusalemin. Ushtarët e kryqëzatave ishin ata që bënë të kundërtën, i masakruan muslimanët dhe i dogjën me flakë shtëpitë e tyre pasi hyn në qytet. Allahu është Dhuruesi i suksesit. ■

VEPRIMTARIA E BANKAVE ISLAME

Banimi është një nga problemet me të cilat përballen shumica e shoqërive bashkëkohore, veçanërisht në vendet islame, si të varfrit, nevojtarët dhe nëpunësit në detyra shtetërore, si dhe ata që kanë të ardhura të ulëta. Bankat islame janë ato që kanë dhënë kontributin e tyre për të zbutur këtë situatë të rëndë me anë të formave shariatike të investimeve

SHKRUAN: LLOKMAN HOXHA

Në numrin e kaluar e kemi theksuar, se mund të shkojë mendja se banka islame (e cila nuk merret me kamatë) është e mangët në kryerjen e shumë aktiviteteve bankare, porse faktet tregojnë që bankat islame bëjnë shumë punë dhe ofrojnë shumë shërbime madje ua tejkalojnë bankave konvencionale, duke hyrë thellë si një partner në sektorin e investimeve, gjë e cila reflektohet pozitivisht në rritjen e ekonomisë kombëtare.

Në vijim do të përmendim disa nga veprimtaritë dhe transaksionet kryesore të bankave islame në përgjithësi.

a. veprimtaria e bankave Islame

Bankat islame ushtrojnë një mori aktivitete të llojeve dhe natyrave të ndryshme, ekonomike shoqërore kulturore etj:

Së pari: veprimtaria ekonomike

Bankat islame ofrojnë të gjitha shërbimet bankare dhe investuese në përputhje me dispozitat e Sheriatit, si dhe i shmangen ushtrimit të të gjitha llojeve të padrejtësisë, si kamata, mashtrimi dhe rryshfeti.

Së dyti: veprimtaria sociale

Bankat islame janë prira për të ofruar shërbime sociale, me qëllim që ta zhdukin prapambetjen në shoqërinë arabe dhe muslimane, si dhe për të kontribuar në ngritjen dhe zhvillimin e saj, duke bërë



thirrje për kursime, duke inkurajuar në shpenzime, si dhe duke vetëdijesuar për mesatarinë në konsum. Aktiviteti social i bankave islame pasqyrohet në shumë gjëra, prej tyre:

1. Qëndrimi në anën e klientit

Duke mos ngritur padi ndaj tyre për shkak të pamundësisë së pagesës së kësteve të merituar, pritja e tyre deri sa të gjejnë zgjidhje, të cilat garantojnë vazhdimësinë e klientëve në veprimtaritë e tyre, duke praktikuar me këtë Fjalën e Allahut te ajeti 280 në suren Bekare: **“Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjeni afatin** (e shlyerjes së borxhit) **derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dini”**.

2. Huadhënia

Për të ndihmuar nevojtarët në rregullimin e jetës së tyre pa asnjë interes kamator, për qëllime humane, si martesë, kurimi, fatkeqësitë e të tjera. Huadhënia pa interes është e pa imagjinuar në bankat konvencionale dhe në shoqërinë kapitaliste, përkundrazi kjo është e deklaruar në mënyrë eksplicite në Kuran dhe Sunet.

3. Fondi i zekatit

Bankat islame brenda tyre kanë të themeluar fondin e zekatit dhe këtë e kanë të rregulluar me norma të caktuara dhe ato monitorohen nga bordi sheriatik për t’u zbatuar në mënyrën më të drejtë.

4. Kontributi në zgjidhjen e problemit të banimit

Banimit është një nga problemet me të cilat përballen shumica e shoqërive bashkëkohore, veçanërisht në vendet islame, si të varfrit, nevojtarët dhe nëpunësit në detyra shtetërore, si dhe ata që kanë të ardhura të ulëta. Bankat islame janë ato që kanë dhënë kontributin e tyre për të zbutur këtë situatë të rëndë me anë të formave sheriatike të

...Se gruaja është më e aftë në punë me motrën e saj, dhe se gratë janë mjaft të afta për ta udhëhequr dhe për ta vënë në funksion veprimtarinë bankare me sukses...

investimeve, si murabeha, istisna, partneriteti etj., të cilat do të sqarohen më poshtë

5. Fondi i zhvillimit social

Ky fond është i formuar nga donacionet vullnetare, të cilat anëtarët ia japin bankës dhe ky fond përdoret për sigurimin e fatkeqësive, që mund t’i godasin depozituesit.

6. Financimi i familjeve të varfra me aftësi prodhuese

Banka islame kujdeset për t’i ndihmuar me financime familjet e varfra, të cilat kanë aftësi produktive të ndryshme, shembulli më i qartë është ai **Muhamed Junusit** pronari i **“Grameen Bank”** i cili fitoi çmimin nobël në vitin 2006.

Së treti: Veprimtaria kulturore dhe arsimore

Bankat islame kanë marrë përsipër përgatitjen e kuadrove udhëheqëse në fushën e bankave islame, dhe kanë themeluar një mori qendrash për ekonomi islame, në Xhida, El Az’har, dhe në disa vende të tjera, ku ndër më të rëndësishmet është **“Instituti Islamik për Studime dhe Trajnim”** pranë Bankës Islamike për Zhvillim në Xhida. Prej aktiviteteve kulturore është edhe mbajtja e konferencave dhe seminareve të shumta për studimin e çështjeve më të reja në fushën e financave islame.

Së katërti: veprimtari të tjera në bankat islame

Bankat islame ushtrojnë edhe një mori

aktivitetesh të llojeve të ndryshme:

1. Themelimi i seksioneve të posaçme për gjininë femërore, gjë të cilën e ka bërë Banka Islame e Dubait dhe të tjera. **Fatima Tamimi**, drejtor i sektorit për zonja në Bankën Islame të Abu Dhabit, ka konfirmuar suksesin e punës në sektorin e saj, duke vërtetuar se gruaja është më e aftë në punë me motrën e saj, dhe se gratë janë mjaft të afta për ta udhëhequr dhe për ta vënë në funksion veprimtarinë bankare me sukses.

2 - Administrimi i trashëgimisë, zbatimi i testamenteve në përputhje me Sheriatin në kontekstin e shërbimeve sociale.

3 - Bankat islame kanë krijuar shumë mundësi pune për djem dhe vajza të reja të diplomuar rishtazi në universitete të ndryshme, si dhe për ekspertët dhe specialistët, duke u ofruar atyre punë të ndershme dhe të ardhura të mira.

b. Transaksionet e bankave islame

Së pari: burimet e bankave islame:

Bankat islame burimet i kanë në radhë të parë nga aksionarët, së dyti nga depozitat dhe së treti nga fitimet që rrjedhin nga aktivitetet bankare.

-Mjetet e aksionarëve, të cilat përbëjnë hiset e tyre të partneritetit në jurisprudencën islame konsiderohen si partneritet në kontratë (sherike anan), ku secili nga partnerët duhet të kontribuojë me pasuri dhe veprimtari, duke mos qenë e domosdoshme pjesëmarrja e barabartë e secilit në pasuri, punë apo kompetenca. Partneriteti i tyre mund të jetë edhe në atë formë partneriteti ku njëra palë merret me punë, ndërsa pala tjetër me financim (sherike mudarebe), si dhe nuk kërkohet shpërndarja e barabartë e dividendëve, por sipas marrëveshjes së tyre me përqindje, nëse ka humbje ajo bie mbi financuesin (pronarin e kapitalit), ndërsa punëmarrësi do të humbasë mundin dhe punën e tij.

-Paratë e depozituesve, përdoren në dy

mënyra:

1- Depozitë jo investuese, në jurisprudencën islame quhet huadhënie (el-kard) nga pronari i parave për një afat të caktuar, duke qenë të garantuara, por pa ndonjë shtesë interesi apo dobi nga ajo.

2- Depozitë investuese, e quajtur në jurisprudencën islame mudarebe, në të cilën pronari i parave i investon ato për të marrë pjesë në ndarjen e fitimit sipas marrëveshjes, me mundësinë e humbjes gjithashtu. Investimet mund të jenë nga më të ndryshmet pastaj mund të jenë afatgjata, por edhe afatshkurta me mundësi tërheqje të lirë apo të kufizuar, dispozitat e tyre do t'i sqarojmë në numrat e ardhshëm.

Së dyti: format e financimit në bankat islame

1. Partneriteti

Feja islame e konsideron kapitalin, si faktor të rëndësishëm të prodhimit, si dhe lejon që me anë të tij të arrijë fitime, jo të garantuara paraprakisht, por pasi ato të realizohen nga sukcesi i projektit të caktuar.

Me partneritet nënkuptojmë: pjesëmarrjen e dy apo më shumë personave, në të holla ose punë, ose që të dyja së bashku për të kryer një veprimtari të caktuar mbi bazën e ndarjes së fitimit, që rezulton nga hisja e secilit, ose sipas marrëveshjes në përqindje, duke qenë pjesëmarrës edhe në humbje gjithashtu.

2. Shitja me këste:

Është ajo shitje, ku artikulli dorëzohet menjëherë pas kontratës, kurse pagesa (çmimi) vonohet në këste të caktuara me afat të caktuar, gjë e cila është e pranueshme për shumicën e dijetarëve.

Rritja e çmimit përballë kësteve është e lejuar, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet në kontratë, por nuk është e lejuar për të rritur çmimin për vonimin e pagesës pas afatit të caktuar, ose për paaftësinë e borxhliut për të paguar, për shkak se kësti

tanimë llogaritet si borxh, dhe shtesa mbi të është kamatë e ndaluar, por në qoftë se vonesa vjen nga debitori (borxhliut) i pasur, ose ai që qëllimisht e zvarrit pagesën, në këtë rast disa mendime bashkëkohore përkrahin idenë, se duhet të ngarkohet me përgjegjësinë e dëmeve të shkaktuara, si pasojë e vonimit, si ndëshkim për të, por duke mos e marrë banka këtë gjobë për vete. (kjo e fundit shpresojmë se do të sqarohet në një nga numrat e ardhshëm)

3. Letrat me vlerë (instrumentet negociuese)

Letrat tregtare janë letra (mjete) që qarkullojnë në mes individëve sikurse paratë, vlera e tyre nuk është në vetvete, por në bazë të asaj që është e shënuar në to. Ato dallojnë nga paratë e rëndomta për nga forma, vlera, autoriteti i lëshimit të tyre etj.

Këto lloj letrash janë disa llojesh, ku më të njohurat janë:

- a. Kambiale,
- b. Çeqe

c. Certifikatat për depozitim, domethëniet dhe dispozitat e tyre do t'i sqarojmë në numrat ardhshëm inshaAllah.

4. **Murabaha:** është ajo formë e shitblerjes, ku klienti kërkon nga banka për ta blerë një produkt të përshkruar, duke i premtuar bankës, se ai do ta blejë prej saj. Këtu banka paguan çmimin në para të gatshme (e blen produktin në emër të vetin), pastaj ia shet klientit në një kontratë të re me një çmim më të lartë me këste, duke mos qenë premtimi detyrues nga dy anët.

5. **Qiraja pronësuese:** Është një qira (pronësi e shfrytëzimit), e cila përfundon me shitje (pronësim të produktit). Kur një produkt, i cili mund shfrytëzohet, por mbetet esenca e tij, banka ia jep klientit, me qira në mënyrë që nëse klienti i paguan me përpikëri këstet e qirasë, atëherë me një kontratë të re duke ia falur apo duke paguar një çmim simbolik, produkti bëhet pronë e tij. Pra, nëse

klienti nuk mund t'i paguajë këstet produkti mbetet në pronësi të bankës, duke i zbatuar dispozitat e qirasë.

6. Partneriteti që përfundon me pronësinë e njëres palë (**partneriteti në rënie**): Kur banka islame bie në dakord me një klient për të qenë partner në një pronë, me marrëveshje ndërmjet tyre që klienti t'i paguajë bankës një numër të caktuar të kësteve periodike, përballë të cilave banka heq dorë nga hiseja e saj në favor të klientit, ku përfundimisht ai bëhet pronar i plotë i pronës.

7. Kontrata e prodhimit "**Istisna**": Është një kontratë shitje, sipas së cilës Banka lidh një kontratë për ofrimin e një malli, ose ndonjë produkti (që nuk është prodhuar ende ose gjatë etapave të prodhimit) në një kohë të përcaktuar me një çmim të rënë dakord. Istisna përdoret gjerësisht në sferën e financimit të ndërtimit të ndërtesave, depove, panairëve, qendrave tregtare etj. Nëse pagesa bëhet në momentin e kontratës (parapagim) kjo në gjuhën e shariatit quhet "selem", ndërsa nëse pagesa bëhet pas dorëzimit të produktit quhet "istisna" dhe secila nga këto ka veçoritë dhe dispozitat saj, të cilat shpresojmë se do t'i sqarojmë në numrat e ardhshëm.

8. **Tevarruk:** Është një kontratë tri palëshe, ku banka i shet klientit një produkt (zakonisht metale në sasi të mëdha) me këste dhe pastaj për të njëjtin produkt klienti e autorizon bankën për t'ia shitur një pale të tretë me para të gatshme, ku në fund paratë i merr klienti i parë duke i mbetur borxh këstet e caktuara bankës për kontratën e parë. Këtë formë shumica e dijetarëve bashkëkohorë e ndalojnë, përveç nëse klienti mund të ketë qasje në produktin e blerë dhe të veprojë në të, përndryshe kjo kontratë është vetëm formale sa për të ardhur tek paratë dhe kthimi i tyre me shtesë. ■

(vijon në numrin e ardhshëm: Shërbimet Bankare Islame)



PIKA KULMORE E DOBËSISË

Me vullnet të fortë i dobëti arrin fuqi, i padituri mëson atë për të cilën ka më shumë nevojë dhe prej një gjëje shumë të thjeshtë mund të shpiket diçka e madhe. Mirëpo, nëse humb vullneti, nuk do të na mbetet asgjë

ABDULKERIM BEKKAR

Për t'u bërë një punë nevojiten dy gjëra: vullneti dhe forca. Nëse pyetni se cila prej tyre është më e rëndësishme, atëherë pa kurrfarë mëdyshje deklaroj se vullneti është më thelbësori. Përse? Për arsye se njeriu, kur dëshiron të arrijë diçka, është vullneti ai që e shtyn në rrugën e duhur për të gjetur mjetet dhe mënyrat e duhura, ashtu siç vepron ai që është i uritur dhe nuk ka as kafshatën e gojës. Preokupimi thelbësor i tij

është ushqimi, ndërsa vullneti i tij i lartë për ta gjetur atë do t'i dhurojë energji dhe do ta shtyjë drejt kërkimit të shpejtë të ushqimit, duke gjetur një mijë mënyra dhe hile për ta siguruar. Me vullnet të fortë i dobëti arrin fuqi, i padituri mëson atë për të cilën ka më shumë nevojë dhe prej një gjëje shumë të thjeshtë mund të shpiket diçka e madhe. Mirëpo, nëse humb vullneti, nuk do të na mbetet asgjë. Paramendoni një njeri, i cili vuan nga një sëmundje kronike, ndërsa afër shtëpisë së tij gjendet spitali më i mirë dhe me shërbime më moderne mjekësore falas,

mirëpo ai për ndonjë arsye refuzon të shkojë në spital dhe gjithë ato mundësi shërimi për të bëhen të pakuptimta, ngase nuk zotëron vullnetin për t'u shëruar. Dëshiroj të theksoj tri pika të rëndësishme:

- Nëse medizioni rreth dallimit mes njerëzve në aspektin fetar, suksesit dhe arritjeve, do të vëreni se ai në mënyrë qenësore lind nga dallimi në vullnet dhe vendosmëri e jo nga dallimi në mundësi dhe fuqi. Një i ri i shëndetshëm është në gjendje të lexojë një orë në ditë, të shkojë për pesë kohët e namazit në xhami, të përshëndesë me selam ata që takon në rrugë, mirëpo nuk bën asnjërin prej tyre. Ndërsa një i ri tjetër i bën këto veprime çdo ditë, sepse zotëron vullnetin, vendosmërinë, potencialin e kështu me radhë.

- Nga mëshira e Zotit ndaj nesh është edhe fakti, se forcimi i vullnetit, i cili përbën faktorin themelor të përparimit tonë është i mundur për të gjithë njerëzit. Kjo është dhurata e Mëshiruesit për ne në përgjithësi, ndërsa për fukarenjtë dhe të mjerët në veçanti. Për shumë njerëz avancimi i aftësive dhe i potencialit nuk është i mundur për shkak të kushteve dhe rrethanave të këqija të tyre. Për këtë shkak kundërshtimi i shumë të rinjve dhe ndalimi për të mos kërkuar më të çmueshmen konsiderohet i pajustificueshëm.

- Në shumicën e rasteve ne e ngatërrojmë fuqinë dhe vullnetin dhe deklarojmë se nuk kemi mundësi të bëjmë këtë apo atë, mirëpo realiteti është se ne nuk dëshirojmë ta bëjmë një gjë të tillë, mirëpo ngurrojmë të themi **“nuk dëshirojmë”** dhe themi **“nuk mundemi”**. Kur munafikët nuk shkuan në luftën e Tebukut u arsyetuan, se ata nuk patën mundësi, ndërsa Allahu i Madhëruar na njofton saktësisht për gjendjen e tyre: **“Dhe ata do të betohen në Allahun: “Sikur të kishim mundur, me siguri do të dilnim bashkë me ju” dhe kështu ata e shkatërrojnë**

“...Nëse ndonjëri prej jush nuk lexon në ditë asgjë, le ta detyrojë veten gjatë vitit të parë me 20 minuta lexim në ditë, vitin tjetër me dyzet minuta në ditë e kështu me radhë...”

vetveten; Allahu e di se ata janë gënjeshtarë.” Më pas tregoi se nuk ishte çështje mundësie dhe force, mirëpo mungesë vullneti, prandaj ajeti thotë: **“Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur.”** Le të meditojë secili prej nesh për punët, statusin dhe çështjet e tij e pastaj le të shohë se problemi i neglizhencës së tij kthehet te vullneti i dobët, apo te mundësia e vogël. Unë jam i bindur se pas një shikimi objektiv dhe të thellë do të rezultojë bindja, se neglizhenca jonë më e madhe shkaktohet nga mosekzistimi i vullnetit.

Pyetja që me të drejtë do të mund të shtroni është: Cila është rruga për të forcuar vullnetin? Përgjigjja mund të përkufizohet në pikat vijuese:

1. Ne kemi shumë nevojë për ndihmën e Allahut Fuqiplotë, që të triumfojmë ndaj unit, epsheve dhe zakoneve tona të këqija. Ndoshta ndihma më e madhe do të ishte luftimi i unit (egos). Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“Ata që luftojnë për çështjen tonë, sigurisht Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona.”** Ndërsa në suren Sexhde në ajetin 24 thotë: **“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm.”** Të gjitha opsionet e tjera, përveç luftimit të

unit janë të padobishme dhe të pavlera.

2. Le të përsërisim fjalët që sugjerojnë vullnetin e fortë: “Unë ia dëshiroj të mirën filanit, unë jam i vendosur t’i fal namazet e detyruara në xhami, unë zotëroj vullnet të fortë, kjo do të bëhet me lejen e Zotit.”

3. Forcimi i vullnetit kërkon një proces të ngadalshëm dhe gradual, duke e detyruar veten me kryerjen e disa detyrave të vogla. Ndërkohë që kjo bëhet pjesë e sjelljes sonë, atëherë shtojmë detyrime të tjera të vogla. P.sh., nëse ndonjëri prej jush nuk lexon në ditë asgjë, le ta detyrojë veten gjatë vitit të parë me 20 minuta lexim në ditë, vitin tjetër me dyzet minuta në ditë e kështu me radhë.

4. Mundohu ta privosh veten nga disa gjëra, që i ke shumë për zemër, vetëm që t’i dëshmosh unit tënd, se kush është ai që drejton. Nëse uni të cyt që të pish një gotë çaj ose lëng apo të bisedosh me një shok për diçka të parëndësishme, atëherë shtyje kërkesën edhe për një orë. Nëse uni të cyt që të dalësh nga xhamia menjëherë pas namazit për të blerë diçka jo të domosdoshme, refuzoje kërkesën në mënyrë kategorike, derisa të ndjesh se ke mundësi vërtet ta dirigjosh veten.

5. Përpiqu pa ndërprerje që të flakësh

“Nëse uni të cyt që të dalësh nga xhamia menjëherë pas namazit për të blerë diçka jo të domosdoshme, refuzoje kërkesën në mënyrë kategorike, derisa të ndjesh se ke mundësi vërtet ta dirigjosh veten...”

një shprehi të keqe dhe të krijosh në vend të saj një shprehi të mirë dhe të dobishme. Nëse vazhdimisht ankohest te të tjerët, çlirohu prej kësaj shprehie dhe vendos në vend të saj falënderimin ndaj Allahut haptazi dhe fshehurazi. Ai që fle më tepër se ç’ka nevojë, le ta braktisë këtë ves dhe le ta shfrytëzojë kohën me diçka të vlefshme.

6. Shoqërohu me njerëz, të cilët njihen për vendosmëri, forcë dhe vullnet të hekurt. Për një kohë të shkurtër do të arrish të përfitosh nga shpirti i tyre i vendosur pa e hetuar fare.

7. Këshillohuni me njerëz të ditur dhe me përvojë, pasi sugjerimi i një eksperti mund t’u kursejë të rinjve pa përvojë mundimet, vite të tëra projektimesh, planifikimesh dhe pasimit të shtigjeve pa rrugëdalje.

8. Shpërblejeni veten për çdo arritje, duke u kënaqur me diçka që e vlerësoni shumë, mirëpo duke qenë gjithmonë brenda kufijve të së lejuarës.

9. Mundohuni të përvetësoni shprehi të reja të mira, të cilat ju ngjajnë me penjtë e artë përmes të cilëve do të thurni sjelljet tuaja.

10. Zelli, ngulmi, durimi dhe përqendrimi janë veçori dhe etikë për të cilat ai që dëshiron të arrijë suksese të jashtëzakonshme, nuk mund të thotë se nuk ka nevojë. Bëjini ato mjetet që do t’i përdorni, si në mirëqenie edhe në vështirësi.

11. Mbështetja tek Allahu dhe përkrahja e Tij janë kriteret bazë të suksesit. Ato mund t’i arrijmë vetëm me sinqeritet dhe moral të lartë. ■

nga arabishtja: A. Terziqi

“JU KENI FENË TUAJ, E UNË KAM FENË TIME!”

BISMILAHİ RAHMANI RAHİM
KUL JA EJJUHEL KAFIRUN. LA
AËBUDU MA TAËBUDUN. UE LA
ENTUM ABIDUNE MA AËBUD. UE LA
ENE ABIDUN MA ABEDTUM. UE LA
ENTUM ABIDUNE MA AËBUD. LEKUM
DINUKUM UE LIJE DIN

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!

“Thuaj: “O ju jobesimtarë! Unë nuk
adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk
jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj!
Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues
i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk
do të jeni adhurues të Atij që unë e
adhuroj! Ju keni fenë tuaj, e unë kam
fenë time!”

SHKRUAN: ALI SHABANI

Kjo sure është emërtuar Kafirun – kaptina
mbi jobesimtarët. Me pak fjalë mund të
them, meqë është sure e shkurtër dhe ka
vetëm gjashtë ajete, ajo paraqet
përmbledhjen e qëndrimit të jobesimtarëve,
politeistëve, mynafikëve – të cilët fshehin
mosbesimin brenda dhe shfaqin të kundërtën

jashtë, dhe ateistëve; gjegjësisht qëndrimin e
jomuslimanëve. Po ashtu nga ana tjetër
Allahu i Madhëruar e porositi Pejgamberin e
tij (kjo vlen edhe për të gjithë besimtarët), që
të mbaj(n)ë qëndrim në fenë e tyre dhe mos
të lëkundet fare, mos të pranojë me ta
asnjëfarë kompromisi.

Loja e djallit dhe e miqve të tij është e
atillë, se kur nuk munden të të shmangin nga
e vërteta tërësisht, atëherë orvaten
pjesërisht. Këto intriga u bënë shkak i zbritjes
së kësaj sure madhështore. Ibën Abasi na e
rrëfen këtë ngjarje, se Velid ibën Mugire, El-
As ibën Vail, Esued ibën Abdulmutalibi dhe
Umeje ibën Halefi e kanë takuar Pejgamberin
sal-lallahu alejhi ue sel-lem dhe i kanë thënë:
“O Muhamed, eja të adhurojmë atë që ti
adhuron dhe po ashtu të adhurosh ato që ne
adhurojmë, e kështu të bashkohemi ne dhe ti
në çështjet tona. Nëse është ajo me të cilën ke
ardhur ti, më e mirë se ajo që bëjmë ne,

atëherë të kemi shoqëruar në të dhe kemi marrë hisen tonë nga ajo, e nëse është më e mirë ajo që ne bëjmë, se sa atë që ke sjellë ti, atëherë na ke shoqëruar në çështjen tonë dhe e merr hisen tënde prej saj.” Për këtë Allahu i Madhëruar ka zbritur **“Thuaj: “O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuronil...”**

Në një transmetim tjetër na përcillet, se mushrikët mekas nga injoranca e thellë që kanë pasur, i kanë kërkuar Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue sel-lem*, që ai të adhurojë zotat e tyre një vit e këta pastaj të adhurojnë Allahun një vit dhe si shkak i kësaj ka zbritur sureja Kafirun.

Urdhri i Allahut në këtë sure, që ia përcjell pejgamberit të Tij: **“Thuaj: “O ju jobesimtarë!”** i dedikohet të gjithë jobesimtarëve, të të gjitha llojeve. Të gjithë ata emëruesin e tyre të përbashkët kanë kufirin, mosbesimin. Allahu i Madhëruar shumë qartë dhe haptas e mëson Pejgamberin e Vet, që të shmanget tërësisht nga feja e tyre duke iu thënë atyre: **“Thuaj: “O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuronil!”**. Mirëpo i tregon atij, edhe nëse jobesimtarët pohojnë se do të adhurojnë Allahun, ajo nuk është e vërtetë. Për këtë shkak i ka thënë, që t’ua shprehi këtë që ata e fshehin brenda: **“As ju nuk jeni adhures të Atij që unë e adhuroj!”**

Dobi nga lëmi i tefsirit: në gjuhën arabe pjesëza “maa” mim me elif të gjatë përdoret për sende, ndërsa “men” mim dhe nun përdoret për frymorë. Mirëpo në këtë ajet “maa” është përdorur me kuptimin e pjesëzës “men”.

Allahu i Madhëruar në Kuran ka treguar për jobesimtarët, se kush janë, çfarë cilësish kanë, çfarë adhurojnë, kujt i vihen pas. Për ta ka thënë: **“...Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykime dhe çka duan vetë, megjithëqë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi.”**Nexhm 23. Allahu që i njeh mirë krijesat e Tij, ua din të dukshmen dhe të

“Shkak i zbritjes së kësaj sureje, siç përmendëm edhe më sipër kishte qenë se kurejshët i ofruan të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ue sel-lem pasuri, saqë të jetë ndër më të pasurit në Mekë, ta martojnë me cilën dëshiron nga gratë vetëm të mos ua sulmojë hyjnitë e tyre...”

fshehtë. Në shumë nga ajetet na ka treguar për jobesimtarët, ndërsa në këtë sure, suren Kafirun pra, na tregon qëndrimin përfundimtar. Ngjashëm Allahu i Madhëruar e ka urdhëruar Profetin t’u drejtohet me një pyetje retorike: **“Thuaj: “O ju injorantë, a mos më thirrni të adhuroj tjetër në vend të Allahut?”**Zumer 64.

“Dhe unë kurrë nuk do të jem adhures i asaj që ju adhuronil!”- Pra qëndrimi edhe më i vendosur shihet në këtë ajet, që mos t’u lejë jobesimtarëve asnjë shpresë se ata mund të bëjnë ndonjë kompromis.

“Por edhe ju nuk do të jeni adhures të Atij që unë e adhuroj!”- Ky ajet përsëritet në këtë sure me ajetin e tretë. Ndodh në Kuran, që një ajet të përsëritet, dy apo më shumë herë dhe po ashtu i njëjti ajet të përsëritet në një sure tjetër. Me këtë përsëritje të këtij ajeti i bën jobesimtarët të dëshpëruar, që mos t’u shkojë fare ndër mend se mund të ndërrojë i Dërguari i Allahut nga qëndrimet e tij.

“Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time!” Kjo i përngjan ajetit 41 në suren Junus: **“Po nëse ata të përgënjeshtroan ty, thuaj: “Mua më takon (shpërblimi nga) vepra ime e juve veprimi juaj, ju nuk përgjigjeni për atë që bëj**

unë, e as unë për atë që bëni ju”.

Allahu i Madhëruar e ka dërguar këtë peygamber për t'i përdhur njerëzit në Fenë Islame, por e ka porositur që vetëm t'ua kumtojnë këtë fe, e mos të ushtrojë dhunë mbi ta. I ka thënë: ***“Ti vetëm kumtoja atyre (ajo që të shpallet)”***. Po ashtu i ka thënë: ***“E ti pra këshillo, se je vetëm përkujtues, Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!”*** Gashije 21, 22.

Po të ndalemi te Kelime Teuhidi: fjalia “la ilahe il-lallahu” (nuk ka të adhuruar me të vërtetë, përpos Allahut), e cila përbëhet prej dy pjesëve, mohim dhe pohim, sureja Kafirun paraqet pjesën e parë, gjegjësisht mohimin. I nderuar lexues, lexoje suren Kafirun dhe analizoje me pjesën e parë të Kelime Teuhidit! Ndërsa pjesën tjetër të pohimit e paraqet sureja Ihlas (Kul huvallahu Ehad). Prej këtu e kuptojmë pse Peygamberi *sal-lallahu alejhi ue sel-lem* i ka lexuar këto dy sure në dy rekatet e sabahut dhe në vitër, sepse me këto dy sure e ka filluar ditën dhe më këto dyja e ka mbaruar. Shkak i zbritjes së kësaj sureje, siç përmendëm edhe më sipër kishte qenë se kurejshët i ofruan të Dërguarit të Allahut *sal-lallahu alejhi ue sel-lem* pasuri, saqë të jetë ndër më të pasurit në Mekë, ta martojnë me cilën dëshiron nga gratë vetëm të mos ua sulmojë hyjnitë e tyre. Mushrikët ishin të gatshëm të sakrifikojnë për idealet e tyre me pasuri dhe me gjithçka. Ne si besimtarë muslimanë, sa jemi të gatshëm ta mbrojmë fenë tonë, sa jemi të gatshëm ta ndihmojmë fenë sonë? Më në fund, sa jemi të përqendruar në fenë tonë? Peygamberi *sal-lallahu alejhi ue sel-lem* për të qartësuar mirë distancimin e tij nga jobesimtarët ka thënë: ***“Kush ngjason me një popull, ai është prej tyre”***. Allahu i Madhëruar e ka lënë zgjedhjen e fesë në vullnetin e njeriut dhe ka thënë: ***“E ti thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë.”*** Kehf 29

Allahu dëshiron që të gjithë të besojnë,

por i ndëshkon ata që refuzojnë besimin, si për shembull mësuesi në shkollë: ai dëshiron të gjithë të mësojnë dhe t'i vlerësojë mirë të gjithë, por nuk mundet t'i vlerësojë ata që nuk mësojnë me nota të larta. Po ashtu drejtori i një fabrike, i cili me plot të drejtë u thotë punëtorëve, kush punon do të marrë rrogën, por kush nuk punon do të marrim masa ndaj tij me mosdhënien e rrogës dhe me përjashtim. Kështu edhe Allahu për ata që refuzojnë të besojnë ka thënë: ***“Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr që muret e tij (të flakës) i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai.”*** Kehf 29, ndërsa për besimtarët ka thënë: ***“E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, s'ka dyshim se Ne nuk i humbim shpërblimin atij që është bamirës. Të tillët e kanë vendin në xhenetin e Adnit, nën të cilin rrjedhin lumenj; e aty stolisen me rrathë të artë dore dhe ata veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e të trashë, janë mbështetur aty në shtretër. Sa shpërblim i mrekullueshëm është dhe sa vend i bukur është ai.”*** Kehf 30, 31

Vlera e kësaj sure: Na përcjellin Muhamed ibën Nasër dhe Taberani në “El-Eusat” nga Ibën Omeri, se i Dërguari i Allahut ka thënë: ***“Kul huvallahu Ehad”*** e ka vlerën sa një e treta e Kuranit, ndërsa ***“Kul ja ejuhul kafirun”*** e ka vlerën sa një e katërta e Kuranit dhe i ka lexuar këto dy sure në dy rekatet sunet të sabahut. Bejhakui na përcjell në Shuabul iman nga Fervete ibën Neufel ibën Muavije El Eshxhei, e ky nga babai i tij, se i ka thënë Peygamberit: O i Dërguari i Allahut, më mëso çfarë të them kur të shtrihem në shtrat. Ai i ka thënë: ***“Lexo “Kul ja ejuhul kafirun” e pasi ta mbarosh, fli se ajo është pastrim nga shirkku.”*** E lusim Allahun Fuqiplotë, që të na mbrojë nga njollat e kufrit, shirkut dhe nifakut. Amin. ■

BUTËSIA ËSHTË DETYRIM FETAR DHE FSHEHTËSI PËR ARRITJE

Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, na përcjell se e ka dëgjuar Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë:

“Butësia kudo që gjendet ajo zbukuron, ndërsa kur largohet nga çdo gjë, ajo veçse e shëmton”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Këtë hadith me këtë tekst e shënon imam Muslimi në Sahihun e tij nr. 2594. Kurse me tekste të përafërta në kuptim e shënojnë edhe imam Buhariu, nr. 6030, gjithashtu Muslimi, nr. 2592, Tirmidhiu, nr. 213 me sened të saktë, Ahmedi, 6/104, të cilin e saktëson Albani në “Sahiha” nr. 523.

Shkaku i thënies së këtij hadithi:

Shkak i përmendjes së këtij hadithi nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, rrëfëhet të ketë qenë rasti i Aishes, e cila ishte duke hipur në deve, por pasi pati vështirësi gjatë hipjes edhe filloi të bërtasë me devenë. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me të dëgjuar fjalët e saj e këshilloi me fjalët e përmendura në këtë hadith të cilin e shënuam në fillim. (Shënon Muslimi)

Komentimi i hadithit:

Fillimisht dua të them se në kapitullin e mirësjelljes, gjegjësisht të butësisë hadithi në fjalë është shumë i rëndësishëm dhe konsiderohet bosht i kësaj teme. Gjithashtu butësia është suksesi i çdo arritjeje përmes së cilës njeriu arrin që çdo punë, fjalë, gjest etj., ta bëjë më mirë dhe të ketë me të më shumë sukses.

Fjala në hadith: **“Butësia kudo që gjendet ajo zbukuron”**

Fjala “Butësi” do të thotë: marrje e çështjeve në formën më të mirë dhe kryerja e gjërave në mënyrën më të bukur dhe të lehtë të mundshme. Pra, e kundërta e vrazhdësisë dhe e ashpërsisë.

Butësia është veti e besimtarëve, të cilën janë të detyruar ta zotërojnë, duke mos lënë tek askush arsyetime me fjalë boshe, se kinse dikush e ka natyrën të tillë dhe është i vrazhdë. Islami na urdhëron me butësi,

mirësjellje dhe lehtësim në të gjitha çështjet. Ky është rregull detyruar, që i hedh poshtë arsyet e kota. Me futjen në Islam, secili prej nesh është i detyruar të bëhet i butë, duke i lënë anash veset e kohës së injorancës. Prandaj askush nuk ka asnjë arsye për vrazhdësinë, pa marrë parasysh çfarë i pjell mendja që të arsyetohet me të. Për fat të keq ka njerëz që sillen vrazhdë dhe janë të ashpër me të tjerët, të cilët kur i pyet pse janë të tillë, ata arsyetohen se në këto kohë nëse bëhesh i butë të tjerët të marrin nëpër këmbë. Ky arsyetim është i kotë dhe bie ndesh me atë që ka përmendur Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ai thotë se butësia është ajo që i ndreq gjërat, kurse vrazhdësia vetëm i prish. Kështu që kush mendon të kundërtën e asaj që thotë Profeti, ai ka gabuar. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në një hadith tjetër thotë: “*Kujt nuk i jepet butësia, atij nuk i është dhënë aspak mirësi.*” (Muslimi2592, Ebu Davudi, Ibën Maxhe, etj.)

Fjala në hadith: “**kudo që gjendet**” d.m.th. pa marrë parasysh butësia ku është, në çfarëdo punë, rasti, etj., ajo veçse e zbukuron dhe e ndreq atë punë dhe nuk ka mundësi që ajo të gjendet diku e ta prishë atë. Kjo është e para. Pra, kudo që e vendosim butësinë ajo sjell dobi dhe në anën tjetër butësinë me këdo që ta përdorim, kam si qëllim me çdo lloj njeriu, besimtar apo jo, të devotshëm apo mëkatarë, të vjetër ose të rinj etj., me të gjithë këta lloje njerëzish duhet të sillemi me butësi. Këtë e vërteton edhe fjala profetike në të cilën përmendet: “*Allahu e do butësinë në të gjitha gjërat.*” (Muslimi) pra, në çdo gjë, në çdo punë, fjalë, sjellje, etj., ndërsa butësia me të gjitha llojet e njerëzve vërtetohet me hadithet e tjera profetike, të cilat tregojnë për sjelljen me butësi të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, disa prej të cilave do t’i përmendim më poshtë.

Dijetarët thonë se butësia sjell dy lloje dobish; e **para**, se njeriu i butë do të

“...Me futjen në Islam, secili prej nesh është i detyruar të bëhet i butë, duke i lënë anash veset e kohës së injorancës. Prandaj askush nuk ka asnjë arsye për vrazhdësinë, pa marrë parasysh çfarë i pjell mendja ...”

shpërblehet nga Allahu në botën tjetër, për shkak se e ka respektuar një urdhër të Allahut të kërkuar nga ai. Ndërsa dobia e **dytë**, ajo në këtë botë ku Allahu i Lartësuar për hir të butësisë së besimtarit nëpër çështje të caktuara i mundëson atij arritjen e qëllimeve, sukseseve, duke i zbukuruar ato, përmes të cilave do t’ia kalojë të tjerëve me punët e tij në cilësi, kështu që edhe në këtë botë nuk mbetet mbrapa shokëve të tij përkundrazi i kalon ata.

Fjala në hadith: “**ndërsa kur largohet nga çdo gjë, ajo veçse e shëmton**”

Pra, e kundërta e asaj që përmendëm deri tani. Mungesa e butësisë lë vend për vrazhdësi e kështu kjo e fundit do të jetë shkak për shëmtimin dhe ngecjen e punëve. Vrazhdësia sjell dëme në këtë botë dhe në botën tjetër, ajo ndalohet me të gjithë njerëzit, bile edhe me armiqtë atëherë kur kërkohet diçka e tillë.

Dua të bëjë një sqarim të vogël: ka njerëz që mendojnë se butësi patjetër do të thotë dobësi, ngase butësia lë vend për dobësi, sepse njeriu i butë nuk mund të jetë në gjendje t’i bëjë ballë armiqve të Islamit, nuk mund ta bëjë përmirësimin me dorën e vet etj. Kjo është gabim, ngase butësi nuk do të thotë lënie e kërkesave dhe e detyrimeve karshi të tjerëve në emër të butësisë. P.sh., nëse dikush ka vjedhur, atëherë për shkak të

butësisë nuk do të thotë të mos i pritet dora. Apo nëse është luftë të mos vritet armiku në betejë e kështu të vrasë ai ty. Butësia dallon nga dobësia, ngase butësi do të thotë edhe vrasje e armikut, por në mënyrën më të mirë të lejuar; do të thotë prerje e dorës së vjedhësit, por me butësi duke mos ia prerë deri në kraharor, apo duke mos ia prerë të dy duart. Për këtë çështje Sufjan Theuriu i pyeti shokë e tij, duke iu thënë: “Çfarë mendoni ju, se është butësia?” Ata i thanë: Na trego ti, o dijetar. Atëherë ai tha: “Butësi është që t’i veprsh të gjitha gjërat sipas masës së tyre të kërkuar. Ta vendosësh forcën ku e ka vendin, respektin ku e ka vendin, shpatën në vendin e saj dhe kamxhikun në vendin e tij.” (Ihja alummuddin, 1/185)

Argumentet që flasin rreth butësisë:

Duke mos pasur mundësi t’i përmend të gjitha do të veçoj disa prej tyre:

Ajete e Kuranit:

“**Në sajë të mëshirës së Allahut u solle butësisht me ta** (o Muhamed). **Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.**” (Ali Imran, 159)

“**Shkoni tek Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë! Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet, a frikësohet!**” (Taha, 43-44)

Hadithet e Profetit, sal-lallahu alejhi ue selem:

“**Kujt i jepet butësia atij i është dhënë mirësi e madhe, e kujt nuk i jepet ajo, atij i është ndaluar mirësia.**” (Tirmidhiu dhe Ibën Huzejme-sahih)

“**Kujt nuk i jepet butësia i është privuar e tërë mirësia.**” (Ebu Davudi, Ibën Maxhe)

Aisheja, *radijallahu anha*, tregon se një ditë çifutët i thanë Profetit, *sal-lallahu alejhi*

ue selem: Es-samu alejkum, që do të thotë: vdekja qoftë mbi ty. Profeti ua ktheu butësisht me fjalën: **Edhe mbi ju**. Aisheja thotë: Unë me të dëgjuar fillova t’u them atyre: Mbi ju qoftë vdekja dhe mallkimi. Profeti me të dëgjuar më tha: “*Ngadalë oj Aishe, Allahu e do butësinë në çdo gjë*”, por unë i thashë: O i Dërguar, a nuk i dëgjove çfarë të thanë? E ai ma ktheu: “*I dëgjova dhe ua ktheva atë përgjigje, a nuk e di se Allahu mua ma pranon lutjen kundër tyre, kurse atyre jo?!...*” (Buhariu, 6030)

Këtu vërehet mjaft qartë, se ai ishte i butë edhe me armiqtë e tij më të mëdhenj dhe ai në këtë rast nuk qëndroi duarkryq e kështu kjo sjellje e tij të konsiderohej dobësi, por ua ktheu ashtu siç e merituan, duke mos e tepruar, por me shumë butësi, gjest ky i cili e vërtetoi sa butësinë aq edhe burrërinë dhe profetësinë e tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

“*Allahu e do butësinë në të gjitha gjërat.*” (Muslimi)

“*Allahu është i Butë dhe shpërblen për butësinë, aq sa nuk shpërblen për vrazhdësinë.*” (Muslimi)

“Një ditë një beduin urinoi në xhami, shokët e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me të parë filluan ta kritikonin. Profeti kur i dëgjoi ju tha atyre: “*Lëreni të qetë, kurse urinës së tij hidhini një kovë me ujë. Mos harroni se jeni dërguar lehtësues (për të tjerët) e jo vështirësues.*” (Buhariu)

“*Oj Ajshe, bëhu e butë, sepse Allahu kur dëshiron të fusë mirësi në një familje i udhëzon të bëhen të butë.*” (Ahmedi, 6/104, sahih).

“*Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos hidhëroni.*” (Buhariu).

Aisheja thotë: “*I Dërguari kur është lënë të zgjedhë mes dy gjërave të lejuara ai ka zgjedhur më të lehtën...*” (Buhariu dhe Muslimi).

Një shok i Profetit i tha atij: O i Dërguar lute Allahun, që ta shkatërrojë fisin Deus.

Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, filloi të lutej me fjalët: “O Allah, udhëzoje Deusin.” (pra, nuk u lut për mallkim por për udhëzim) (Buhariu dhe Muslimi).

Në Taif populli i atij vendi e gjuajtën me gurë, deri sa e përgjakën të tërin e ai duke vrapuar me duar në kokë, duke u mbrojtur nga gurët lutej: “O Allah, fale popullin tim, se nuk e dinë (kush jam).” (Buhariu dhe Muslimi).

Profeti ishte i butë edhe me kafshët.

Ai thotë: “Kur të udhëtoni me devetë tuaja, nëse kaloni nëpër kullosa, atëherë lërin ato për pak kohë që të hanë prej asaj kullose. Ndërsa nëse udhëtoni në vende pa kullosa mos u vononi, por ecni më shpejt sa janë të forta, kështu të arrini në destinacionin tuaj pastaj ushqejini...” (Muslimi)

“Një grua ka për të hyrë në zjarr për shkak të një maceje. E ka mbyllur atë duke mos i dhënë ushqim e as duke mos e lënë të ushqehet nga mbeturinat e tokës.” (Buhariu dhe Muslimi)

“Allahu urdhëroi butësi me çdo gjë. Kur mbytni, të mbytni sa më mirë dhe kur t’i therni kafshët, therni sa më mirë, mpriheni thikën kështu do ta qetësoni kafshën.” (Muslimi).

“Profeti ndaloi të merrej shënjestër për gjuajtje çdo gjë që është e gjallë.” (Muslimi)

Një ditë Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kaloi pranë një deveje të dobët, së cilës i ishte ngjitur barku me shpinën dhe me këtë rast tha: “Frikësojuni Allahut ndaj këtyre kafshëve, ngase ato nuk flasin, ngarkojini me masë dhe ushqejini mirë.” (Ebu Davudi, hasen)

Kjo pra, është Feja Islame, feja e paqes dhe e butësisë, e respektit ndaj çdo krijese që ka shpirt dhe merr frymë. Feja e paqes larg çdo vrazhdësie, veti kjo e fundit që s’i takon asnjë muslimani përkundrazi i vishet fesë tonë nga ata që vetë janë të tillë. Veprojnë kështu për

“...Butësi është që t’i veprosh të gjitha gjërat sipas masës së tyre të kërkuar. Ta vendosësh forcën ku e ka vendin, respektin ku e ka vendin, shpatën në vendin e saj dhe kamxhikun në vendin e tij...”

të mbuluar jo vetëm vrazhdësinë e tyre, por edhe krimet e veta përmes sulmit dhe propagandës, sepse kanë si rregull të tyre strategjinë: “Sulmi është mbrojtja më e mirë”. Atë që ka mbjellë Islami para një mijëvjeçari e gjysmë dikush sot për interesa personale vetëm e pretendon. Për t’ua mbushur mendjen të tjerëve vetëm e pretendon atë. Islami ka mëshirë për macen, zogun dhe pulën, ndërsa dikush nuk ka mëshirë as edhe për njerëzit. Por si mund të ketë mëshirë për të tjerët ai që nuk ka mëshirë për fëmijën e vet, e hedh në kontejner për të jetuar me qenin e “dashur”. Sakrifikon fëmijën, ndërsa në anën tjetër i nxjerr pasaportë qenit me pretekst se është i mëshirshëm dhe tregon butësi. Larg, larg çdo etike dhe butësie janë njerëzit e tillë. Kur humbin peshojat, atëherë gjërat nuk kanë me çfarë të maten dhe kështu patjetër do të ndodhë. Kështu ndodh me ata që janë larg mësimeve të Islamit, të humbur në këtë botë, të mashtruar me marrëzitë e tyre dhe të humbur edhe në botën tjetër.

Allahun e falënderoj që më bëri musliman, ma mësoi butësinë ndaj çdokujt, më tregoi etikën e vërtetë, sjelljen me të gjithë, prandaj jam faqebardhë kudo që shkoj dhe para çdokujt pa marrë parasysh sa mundohen të tjerët të më shesin mend. ■

SHKENCËTARËT E HUTUAR

Kurdo që do të hasim në kritikën drejtuar kundër Kuranit do të gjejmë edhe zbulime shkencore, që vërtetojnë dhe argumentojnë të kundërtën: që Kurani është e vërteta, e jo ajo që flitet kundër tij. Dhe ja mu kjo ndodh, ngase Allahu i Madhërishëm thotë në Kuranin fisnik: "Allahu kurrësi nuk ua mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët". (Nisaë, 141)

SHKRUAN: PRIM. DR. MED. SC. ALI F. ILJAZI

Skeptikët janë përpjekur gjithnjë ta nënvlerësojnë Kuranin Fisnik dhe janë munduar të tregojnë, se ajo që gjendet në të është në kundërshtim me shkencën dhe faktet e zbuluara shkencore, dhe që është i mbushur plot me legjenda dhe tregime, të cilat janë larg nga e vërteta, realiteti dhe logjika shkencore. Si shembull dhe argument të pohimeve të tyre përmendin tregimin kuranor për djelmoshat e shpellës (kaptina Kehf). Në lidhje me këtë ndodhi bëjnë këto pyetje: Si është e mundur që djelmoshat të flenë kaq shumë vjet, të flenë me sy të hapur, e pastaj të zgjohen? E pastaj theksojnë se kjo është në kundërshtim me ligjet e mjekësisë dhe se ky fenomen nuk mund të shpjegohet nga perspektiva mjekësore. Qoftë i lavdëruar Allahu i Madhërishëm!

Kurdo që do të hasim në kritikën drejtuar kundër Kuranit do të gjejmë edhe zbulime shkencore, që vërtetojnë dhe argumentojnë të kundërtën: që Kurani është e vërteta, e jo ajo që flitet kundër tij. Dhe ja mu kjo ndodh, ngase Allahu i Madhërishëm thotë në Kuranin fisnik: "Allahu kurrësi nuk ua mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët". (Nisaë, 141)

Ernest Kretschmer zbuloi një fenomen relativisht të ri në vitin 1940, e më vonë këtë fenomen e përshkruan shkencëtarët B. Jennet dhe F. Plum dhe e quajtën "gjendje vegetative". Në këtë gjendje pacienti është në gjendje kome të zgjuar, sytë e tij janë të hapur, ndonjëherë buzëqesh, dhe ndien çfarë ndodh rreth tij dhe është në gjendje të përpijë pështymën e tij. Pacienti është pjesërisht në gjendje të vetëdijshme, duket si me qenë i zgjuar, ndërsa në realitet është në gjendje kome të zgjuar. Kjo ndodh gjatë lëndimeve të kokës ose sëmundjeve të ndryshme.

Studimet që janë bërë me FMRI (Functional magnetic resonance imaging-rezonanca magnetike funksionale) treguan që truri i njeriut është aktiv gjatë komës, ose në gjendjen letargjike dhe që pacienti në këtë gjendje mund të qëndrojë me vite të tëra. Por, ja çfarë i hutoi shkencëtarët: Ç'është ajo që stimulon trurin? Ç'është ajo që e mban pacientin në jetë, bile edhe në gjendjen e pavetëdijes së plotë? Dhe çfarë është ajo që e bën pacientin, kur sapo zgjohet, fillon të flasë, sikur nuk ka ndodhur asgjë?

Në fillim shkencëtarët kanë menduar që kjo gjendje është vetëm një gjumë i thellë, por

më vonë u bë e qartë, që ky nuk është gjumë, por një fenomen i veçantë dhe gjendje e pashpjeguar. Këtu duhet theksuar edhe ajo që pacienti në këtë gjendje ushqehet në mënyrë speciale dhe ushqim special (infuz, sondë nazo-gastrike). Shkencëtarët thonë se truri i pacientit jep shenja që tregojnë reaksion në mjedis; pacienti nuk mund të lëvizë dhe i përgjigjet ngacmimeve të jashtme, por është pa vetëdije.

Nëse e shikoni në këtë gjendje, pacienti duket si me qenë i zgjuar; nëse i drejtoheni truri i tij do të reagojë ndaj urdhrave, por pacienti është në letargji dhe pa vetëdije.

DJELMOSHAT E SHPELLËS (As'habul Kehf)

Allahu i Madhërishëm në kaptinën Kehf na lajmëron për disa djelmosha, që e besuan sinqerisht Zotin e tyre dhe që ikën nga sundimtari i padrejtë për ta ruajtur besimin e tyre. Ata gjetën strehim në një shpellë dhe Allahu i Plotfuqishëm, i nderoi me një mrekulli të madhe, që të mbesin si shembull për njerëzit e kohës së tyre, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Allahu i Madhërishëm në Kuranin Fisnik urdhëron e thotë:

“Kur djelmoshat u strehuan në shpellë thanë: “O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!” Ne u vumë mbulojë mbi veshët e tyre (i vumë në gjumë) në shpellë për disa vite me radhë. Pastaj ata u zgjuan (prej gjumit) për të parë se cili prej atyre dy grupeve është më preciz me njehsimin e kohës sa qëndruan gjatë”. (Kehf, 10-12)

Nëse mendojmë për këtë tregim, do të shohim që është i ngjashëm me fenomenin mjekësor të përmendur më sipër, sipas mënyrës se si djelmoshat e shpellës kanë fjetur dhe kanë lëvizur nga e djathta në anën e majtë. Shkencëtarët që kanë skanuar trurin e pacientëve në gjendje vegetative thonë se rezultatet e skanimit treguan që aktiviteti i trurit të këtyre pacientëve është i ngjashëm me aktivitetin e njerëzve të shëndoshë. Pacientët duken tërësisht normal dhe

shikuesve ju duket si me qenë të zgjuar. Këtu do të përmendim fjalët e Allahut të Madhërishëm, kur flet për djelmoshat e shpellës: ***“Do të mendoje se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin fjetur...”*** (El Kehf, 18)

Dhe duke përshkruar lëvizjet e tyre nga e djathta në të majtë, e që është reaksion normal, i cili tregon personin kur flenë. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Do të mendoje se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin fjetur, e Ne i rrotullonim herë në krahun e djathtë e herë në majtin...”*** (Kehf, 18)

Nga e tërë kjo mund të konkludojmë, që përshkrimi kuranor i tregimit për Djelmoshat e Shpellës është shumë logjik, por ajo që është e çuditshme në këtë histori është se djelmoshat kanë fjetur shumë gjatë - 309 vjet, pa ushqim dhe ujë, por kjo ishte një dhunti e Allahut të Madhërishëm për të cilën ne besimtarët nuk dyshojmë fare. Duke folur në gjuhën medicinale, gjumi i cili zgjati shumë vite është një gjë normale.

SHKENCËTARËT E HUTUAR

Një paciente amerikane qëndroi gjashtë vjet në gjendje vegetative dhe papritmas u zgjua e filloi të flasë me familjen e saj, sikur të mos kishte ndodhur gjë. Ajo qëndroi në gjendje të vetëdijshme tre ditë, duke biseduar normalisht me njerëzit rreth saj dhe përsëri u kthye në gjendje vegetative! Mjekët thanë se ajo u zgjua katër herë gjatë gjendjes së saj letargjike. Ajo që i huton mjekët është fakti, se kjo gjendje nuk është, as gjumë, as koma. Është e mahnitshme që Allahu i Madhërishëm i përshkruan në të njëjtën mënyrë gjendjen e djelmoshave të shpellës kur thotë: ***“Do të mendoje se ata janë të zgjuar, ndërsa ata ishin fjetur...”*** (Kehf, 18)

Dhe në fund konkludimi dhe mesazhi për të gjithë ata që ende dyshojnë në Librin e Allahut është: ***“Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të bënin një si ky, sado që ata do ta ndihmonin njëri-tjetrin”.*** (El Israë, 88). ■

KUSH E DO NJERËZIMIN MË SHUMË SE ISLAMI?!

ISLAM
PEACE

Si e shikon Islami njerëzimin, a nxit Islami në dashuri dhe respekt për ta, si qenie njerëzore, pa marrë parasysh fenë apo prejardhjen e tyre?

Përgjigjet: Muhamed ibën Salih Munexhid

Falënderimi dhe lavdërimi qofshin për Allahun:

Së pari: Islami e vështron njerëzimin përplot mëshirë e dashuri, ndryshe s'mund të jetë, sepse feja Islame është feja e fundit e zbritur nga Allahu. Të gjithë njerëzit urdhërohen ta përqafojnë këtë fe, e cila iu shpall njeriut më të mëshirshëm, Muhamedit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të: **“E ne të dërguam ty vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”** (Enbija: 107)

Këtë mund ta vërtetojmë me Kuran, Sunet dhe me raste nga jeta e të Dërguarit të Allahut:

Thirrja në Islam dhe shpëtimi i njerëzve nga idhujtaria dhe mosbesimi:

Lidhur me këtë në Kuran dhe Sunet gjejmë shumë urdhra për t'i thirrur njerëzit në monoteizëm dhe për t'i larguar ata nga adhurimi i njerëzve, si dhe për t'i nxjerrë nga ngushtica e kësaj dynjaje në gjerësinë e dynjasë dhe Ahiretit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të**

shpëtuarit.” (Ali Imran: 104)

Bamirësia ndaj prindërve edhe nëse janë jomuslimanë:

Madje edhe nëse japin tërë mundin për t'i penguar fëmijët e tyre nga Islami dhe për t'i kthyer në idhujtari e mosbesim. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjirin.** (E porositëm) **Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer nga Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar.”** (Lukman:14-15)

Porosia për sjellje të mira me fqinjët, edhe nëse janë jomuslimanë:

S'ka mundësi të gjesh fe, drejtim apo kanun, që i thërret njerëzit të tregojnë mirësjellje me fqinjët si Islami. Allahu i Madhëruar thotë: **“Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj**

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

fqinjtit të afërt, ndaj fqinjtit të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. Allahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.” (Nisa: 36) Kurtubiu gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: “Ka thënë Neuf Shamiu “ndaj fqinjtit të afërt” bëhet fjalë për muslimanin, kurse me “ndaj fqinjtit të largët” bëhet fjalë për çifutin apo të krishterin.” Në bazë të kësaj themi se porosia për mirësjellje ndaj fqinjtit është një urdhër, një vepër e mirë, qoftë ai musliman apo jomusliman. Kjo është e vërteta. Bamirësia ndaj tyre, që është përmendur në Kuran ka kuptimin e ngushëllimit, që duhet t’i shprehim atyre, mirësjelljes, mosdëmtimit dhe mbrojtjes së tyre. Buhariu ka shënuar një hadith, të cilin e përcjell Aishja nga i Dërguari i Allahut: “*Xhibrili vazhdimisht më ka porositur për mirësjellje ndaj fqinjtit, saqë kam menduar se do ta bëj trashëgimtarin tim.*” Po ashtu në një hadith tjetër të përcjellë nga Ebu Shurejhi, i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Pasha Allahun, nuk ka besuar, pasha Allahun nuk ka besuar, pasha Allahun nuk ka besuar!*” E pyetën: Kush, o i Dërguari i Allahut? Tha: *Ai, fqinji i të cilit nuk është i sigurt nga dëmet e tij.*” Këto porosi janë të përgjithshme për çdo fqinj. I Dërguari i Allahut mosdëmtimin e tij e përforcoi duke u betuar tre herë dhe se ai që bën një gabim të tillë nuk e ka plotësuar imanin. Besimtari duhet të ketë kujdes, që të mos shqetësojë fqinjin e tij dhe të ndalohet nga gjërat, që i ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, si dhe t’i përkushtohet gjërave, që ata i duan dhe kanë nxitur në to.” (Tefsir Kurtubij: 5: 183-184).

Drejtësia dhe bamirësia në lidhje me jomuslimanin me të cilin kemi paqe:

Lidhur me këtë Allahu i Madhëruar thotë: ***“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.***” (Mumtehane: 8) Abdurahman Sadiu, Allahu e mëshiroftë, gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: “Allahu nuk ju ndalon bamirësinë, mbajtjen e lidhjeve, e të mirës me të mirë, korrektësinë me

idhujtarët qofshin të afërmit tuaj apo të tjerë, ngaqë ata nuk ju kanë luftuar për shkak të fesë, nuk ju kanë dëbuar nga shtëpitë tuaja, prandaj nuk është mëkat që t’i mbani lidhjet me ta, ngase aty s’ka ndonjë gjë të ndaluar apo ndonjë dëm.” (Tefsiri Sadi: 856).

Dënimi i ashpër për atë që vret një jomusliman me të cilin jemi në paqe:

Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, thotë: “*Kush vret një jomusliman me të cilin jemi në paqe, nuk do ta ndiejë erën e xhenetit, edhe pse era e tij ndihet dyzet vite larg.*” Ibën Haxheri, Allahu e mëshiroftë, thotë: Në këtë hadith bëhet fjalë për jomuslimanin, i cili ka bërë marrëveshjen e xhizjes, armëpushimit apo sigurisë që ia ka dhënë një musliman. (Fet-hul Bari: 12:259)

Ndalohet padrejtësia ndaj jomuslimanit me të cilin jemi në paqe dhe ngarkimi i tij përtej mundësive:

Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “*Dijeni se ai që i bën padrejtësi një jomuslimani me të cilin jemi në paqe, ai që e nënçmon atë, e ngarkon përtej mundësive, i merr diçka pa dëshirën e tij, unë do të jem kundërshtar i tij Ditën e Gjykimit.*” (Sahih Ebu Davud). Muhamed ibën Salih Uthejmini thotë: “Jomuslimanët që vijnë në vendet tona për të punuar, për tregti me procedurë të rregullt, me ta jemi në paqe apo i kemi dhënë garanci, prandaj nuk lejohet cenimi i integritetit të tyre. Është vërtetuar se i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Kush vret një jomusliman me të cilin jemi në paqe, nuk do të nuhasë erën e xhenetit.*” Ne jemi muslimanë, i jemi dorëzuar urdhrit të Allahut, respektojmë rregullat e Islamit për sa i përket jomuslimanëve me të cilët kemi marrëveshje, u kemi dhënë siguri. Ai që i nëpërkëmb këto rregulla i ka bërë keq Islamit, e paraqet atë me petkun e terrorizmit, mashtrimit, tradhtisë, kurse ai që i përmbahet dispozitave të Islamit, respekton marrëveshjet dhe garancitë, ky është ai për të cilin shpresojmë hairin dhe shpëtimin. (Fetava Uthejmin 25: 493)

Ndalohet shkelja e kufijve, kurse drejtësia është detyrim:

Allahu i Madhëruar thotë: **“Urrejtja ndaj një populli, që ju pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre.”** (Maide: 2), po ashtu thotë: **“...dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë.”** (Maide: 9) Shenkiti, Allahu e mëshiroftë, gjatë komentimit të këtij ajeti thotë: Shiko virtytet e larta në këto ajete, urdhrin që të jesh i drejtë me ata të cilët të kanë dëmtuar.” (Edvaul bejan: 3:50)

Së dyti: sa bashku më atë që u përmend më lart na duhet ta vendosim theksin edhe mbi disa gjëra të rëndësishme:

Ajo që po ndodh në botë e që është në kundërshtim me rregullat që i sqaruam më lart, janë vepra të atyre që i bëjnë (veprime individuale) dhe nuk i atribuohen Islamit. Në çdo fe ka njerëz të tillë, që i kundërshtojnë dispozitat e fesë që i takojnë dhe nuk i përmbahen normave të saj.

Ajo që ka parë bota nga jomuslimanët assesi nuk mund të krahasohet me atë që kanë bërë muslimanët. Dy luftërat botërore, ku kanë humbur jetën afër 70 milionë njerëz ishin luftëra “të krishtera”. Me dhjetëra milionë muslimanë janë vrarë nga duart e të krishterëve në ekspeditat kryqtare dhe të tjera, nga komunistët, çifutët, hindusët, sikhët dhe një sqarim i hollësishëm do të na merrte shumë kohë, mirëpo këto fakte të gjithë i dinë dhe i mohon vetëm ai që e ka lënë mendja. Shtoji kësaj edhe faktin, se pushtimi i trojeve të muslimanëve dhe heqja e lirisë për të vendosur ata vetë ka qenë prej kohësh dhe është në duart e jomuslimanëve nga fe të ndryshme. Le të dihet kjo gjë, kur flitet për atë se si e shikon Islami njerëzinë, për dashurinë dhe le t'i krahasojnë historianët objektivë çlirimet e muslimanëve dhe ekspeditat kryqtare, si ka qenë gjendja e çdonjërit, për të dalë në shesh dallimi i qartë mes mëshirës dhe ashpërsisë, dashurisë dhe urrejtjes, jetës dhe vdekjes.

Së treti: ajo që përmendëm më lart, se si i shikon Islami jobesimtarët dhe se dispozitat e tij

shprehin kulmin e dashurisë dhe dhembshurisë për njerëzit, nuk nënkupton distancimin e muslimanëve nga parimet e tyre, të cilat disa muslimanë mundohen t'i mjugullojnë. Prej tyre janë:

Islami e ndalon dashurinë dhe miqësimin me mosbesimtarët me zemër. Ai që logjikon mund të vërejë dallimin mes bamirësisë, drejtësisë, dhembshurisë, mëshirës me të cilat urdhërohemi kundrejt mosbesimtarëve paqësorë dhe ndalimit të dashurisë me zemër për shkak mosbesimit të tyre, mohimit të Zotit të botëve dhe mospranimit të Islamit.

Nuk lejohet që femrat muslimane të martohen me jomuslimanë, kurse meshkujve iu lejohet që të martohen me femra të krishtera apo çifute. S'ka dyshim se ndikimin kryesor në këtë çështje e ka besimi islam. Ky vendim është një mëshirë e madhe për njerëzit, në mënyrë që femrës së krishtere apo çifute t'i hapet dera e shpëtimit, duke pranuar Islamit, kurse femrës muslimane t'i mbyllet dera e mosbesimit.

Në Islam nuk lejohet detyrimi i mosbesimtarëve për ta pranuar këtë fe, sepse sinqeriteti është prej kushteve kryesore të pranimit të Islamit, Allahu thotë: **“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota.”** (Bekare: 256)

Nga ligjet e sheriatit tonë është: gurëzimi i lavirit të martuar, prerja e dorës së vjedhësit, fshikullimi i shpifësit në nder. Këto ligje nuk i fshehim, porse besojmë se e tërë toka është e nevojshme për t'i praktikuar. Ata që jetojnë me këto ligje kanë siguruar paprekshmërinë e nderit, pasurisë dhe jetëve të tyre. Ai që mediton mbi këto ligje do të shohë se ligjësimi i tyre e pengon qysh në fillim shkeljen e të drejtave të njerëzve, nga ana tjetër kush mediton rreth gjendjes së Perëndimit dhe sheh përhapjen e dhunës, vjedhjes, vrasjes do të kuptojë detyrimisht, se nevoja për ndalimin e këtyre krimeve është më se e nevojshme. Ata kanë provuar ligjet joislame dhe çfarë fituan përveç shtimit të së keqes. ■

INDONEZIA, VENDI ME MË SHUMË MUSLIMANË



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Republika e Indonezisë.

Kryeqyteti: Xhakarta.

Sipërfaqja: 1.919,440 km².

Banorët deri më 2009: 240,271,522

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 1.2%

Përqindja e muslimanëve: 94 %.

Gjuha : Indoneziane.

Monedha : Rupiah (IDR).

Pavarësinë: 17 Gusht 1945 (nga Holandezët).

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 24 Tetor 1945.

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Ana Gjeografike:

Indonezia përbëhet nga 17.508 ishuj, rreth 6.000 prej të cilave janë të banuara. Ishujt janë të shpërndarë në të dyja anët e ekuatorit. Pesë ishujt më të mëdhenj janë Java, Sumatra, Kalimantan (pjesa Indoneziane e Borneos), Guineja e Re (ndahet me Papua Guineja e Re), dhe Sulawesi. Kryeqyteti, Xhakarta gjendet në Java dhe është qyteti më i madh i vendit, i ndjekur nga Surabaja, Bandung, Medan dhe Semarang.

Indonezia është vendi i 16-të në botë për nga sipërfaqja. Dendësia mesatare e popullsisë në të është 134 njerëz/km², d.m.th. vendi i 79-të në botë, edhe pse Java është ishulli më i populluar në botë. Ai ka një dendësi të popullsisë me 940 njerëz/km². Me një popullsi prej rreth 240 milionë njerëz, ai është vendi i katërt më i populluar në botë dhe ka popullsinë më të



madhe islame në botë. Vendosja e Indonezisë në skajet e Paqësorit, Euro-Azisë dhe pllakën tektonike australiane, e bën atë vendin e vullkaneve të shumta dhe tërmeteve të shpeshta. Indonezia ka të paktën 150 vullkane aktive, duke përfshirë Krakatoan dhe Tamboran, të dy të famshëm për shpërthimet

e tyre shkatërruese në shekullin e 19-të.

Ndër fatkeqësitë e fundit për shkak të aktivitetit sizmik përfshin këtu cunamin më 2004, që vrau rreth 167.736 njerëz në Sumatran e Veriut dhe tërmetin në Jogakarta 2006. Megjithatë hiri vullkanik është një kontribuues i madh për pjellorinë e lartë bujqësore e që ka sjellë historikisht si pasojë rritjen e numrit të banorëve në Java dhe Bali.

Ana Historike:

Supozohet se arkipelagu indonezian është

banuar qysh nga kohët shumë të lashta, por popullsia e tij moderne, që sot përbën shumicën e Indonezisë kanë ardhur nga Tajvani 2000 vite p.e.s. Që nga shekulli i shtatë lulëzoi mbretëria e “Srivijajas”, e cila solli me vete edhe ndikimin e hinduizmit dhe budizmit. Mbretëria e fundit jomuslimane “Majapahit” lulëzoi nga fundi i shekullit 13-të dhe ndikimi i saj shtrihej mbi shumicën e Indonezisë.

Dëshmia më e hershme për prezencën e Islamit në Indonezi daton në shekullin e 13 në Sumatran veriore. Islami u bë gradualisht feja dominuese në Java dhe Sumatra nga fundi i shekullit 16 -të. Ata që e bartën Islamit tek indonezianët ishin tregtarët muslimanë, të cilët treguan moral të lartë gjatë tregtisë dhe me sjelljet e tyre arritën të përfitonin banorët e atjeshëm. Çështja e pranimit të Islamit nga banorët e ishujve të Indonezisë përbën një rast të veçantë për t'u studiuar, si nga jomuslimanët ashtu edhe nga muslimanët.

Jomuslimanët me Indonezinë kanë rastin e shembullin më të mirë për të kuptuar çiltërsinë e mësimave islame dhe përshtatshmërinë e tyre me natyrshmërinë njerëzore. Kështu që kurdo që ta kuptojnë Islamit larg prej “fobive” të shumta dhe keqkuptimeve të fabrikuara, aty do të gjejnë shpëtimin për veten dhe rrugën e drejtë për mirëqenien e tërë njerëzimit.

Ndërsa muslimanët duhet të kuptojnë se parimet e drejta dhe dhuntia e Islamit duhet të shfaqet pikësepari në veprat dhe marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Ata tregtarë ndoshta nuk kanë qenë të pajisur me ndonjë dije të madhe rreth Islamit, por sinqeriteti dhe vepra e mirë ka bërë që sot Indonezia – një ndër shtetet më të mëdha në botë - të radhitet ndër vendet islame dhe të jetë shembulli më i mirë, se Islami nuk është përhapur e as nuk është pranuar nga popujt e ndryshëm me fuqinë e shpatës, por me forcën e arsyes dhe bukurinë e mirësjelljes.

Indonezia iu nënshtrua kolonializmit për shekuj me radhë. Të parët që e pushtuan Indonezinë ishin portugezët, të cilët pasi e kishin forcuar flotën e tyre ishin nisur për të kërkuar toka të reja, prania e tyre daton që nga viti 1512. Ata dëshironin të shfrytëzonin të mirat në

Indonezi dhe krahas kësaj të zgjeronin përpjekjet misionare të kishës katolike romake.

Pas tyre erdhën holandezët të cilët ishin më të organizuar dhe përmes mbretërive të vogla dominuan për një kohë të gjatë gjersa u bënë ndër perandoritë më të fuqishme të asaj kohe. Të gjitha këto shtete kolonialiste në vetvete kishin qëllime misionare të krishtere, por përpjekjet e tyre dolën të dështuara dhe sot e kësaj dite Indonezia vazhdon të jetë kala e Islamit në lindje të rruzullit tokësor.

Indonezianët nuk u pajtuan me kolonialistët për këtë Iskender Muda – një nga mbretërit muslimanë - u mundua t'i dëbonte portugezët në vitin 1628. Përpjekjet vazhduan edhe ndaj holandezëve ku më 17/8/1945 u largua nga vendi përfundimisht edhe kolonializmi holandez.

Ana politike:

Indonezia pas pavarësisë zgjodhi kryetarin e saj të parë, i cili ishte Ahmed Sukarno. Kongresi i Babungut, të cilin e thirri Sukarno i hapi rrugën një bashkëpunimi më të thellë Aziatik – Afrikan dhe e çoi vendin drejt formimit të aleancës së shteteve të painkuadruara.

Pas tij pushtetin e mori Suharto, i cili edhe pse ndikoi në zhvillimin e vendit si dhe për sigurinë e tij, ai u cilësua si diktator dhe shfrytëzues, ku miliarda dollarë u gjetën në pronësi të tij dhe familjes së tij. Ai e drejtoi Indonezinë me dorë të hekurt për 32 vite dhe vdiq në vitin 2008. Indonezia është republikë me sistem presidencial dhe kryetari zgjidhet nga populli. Mandati i tij është pesëvjeçar dhe ka të drejtë të kandidohet vetëm dy herë. Zgjedhjet e para presidenciale janë mbajtur në vitin 2004.

Timori Lindor ishte një krahinë e Indonezisë që nga largimi i Portugezëve në vitin 1976. Pasi u larguan portugezët nga Timori Lindor, ai u vendos nën kontrollin e forcave indoneziane nën udhëheqjen e Suhartos. Që nga ai vit e gjer më 1999 ka qenë nën sovranitetin e Indonezisë, e cila lëshoi sovranitetin e saj në vitin 1999. Pas një periudhe të një administrate kalimtare nga Kombet e Bashkuara, Timori Lindor u shpall shtet i pavarur në vitin 2002.

Harta e Timorit Lindor

“Dyshimet në përpjekjet e Perëndimit për finalizimin e pavarësisë së Timorit Lindor janë të mëdha, duke u nisur nga fakti se Perëndimi ishte ai që e përkrahu referendumin e vitit 1976 të banorëve të Timorit Lindor për t’iu shkëputur vendit amë- Indonezisë. Ky ndryshim në qëndrime nga shumë analistë shihet si një përpjekje e formimit të një shteti të krishterë, i cili do të ishte mollë sherri për vendet islame në rajon dhe do të shërbente si ngushëllim ndaj dëshpërimit të misionarëve të krishterë ndaj dështimit fatal në Indonezi.”

Indonezia dhe misionarizmi i krishterë:

Prania islame vazhdimisht i është ekspozuar një operacioni likuidimi të vazhdueshëm nga forcat e kryqëzatave. Islami ishte feja kryesore në Java, një rajon që përfshin tani Filipinen dhe Indonezinë. Aty nuk ka pasur prani të krishterë, saqë edhe udhëtari i njohur maroken Ibn Batuta - në shekullin e tetë sipas hixhretit - i ka vizituar ato vende dhe pati qëndruar për një kohë të gjatë aty, por nuk ka përmendur të ketë pasur ndonjë prani të krishterë. Me ardhjen e kolonialistëve të Spanjës, Portugalisë dhe Holandës e Anglisë filluan të formohen disa zona të krishtera, bile spanjollët arritën ta impononin me dhunë Krishterimin në ishujt e Filipineve. Megjithatë është për t’u theksuar, se filipinasit janë njerëzit që i përgjigjen shpejt ftesës për të hyrë në Islam, për shkak se e ndjejnë që origjina e tyre është islame.

Indonezia përmes një kolonializmi të gjatë dhe më pas përmes përpjekjeve të vazhdueshme të Kishës ka qenë për një kohë shumë të gjatë synim i misionarëve të krishterë, saqë kishat e kishin bërë të tyren parullën: “Indonezia e krishterë në vitin 2000”. Meqë dështuan në këtë qëllim filluan të mendojnë për copëtimin e Indonezisë dhe pas asaj që ndodhi me Timorin Lindor tashmë e kanë kthyer vëmendjen drejt “Ishujve të Mbretërve-Molukas” për të cilat kanë menduar fillimisht të zhdukin praninë islame e shoqëruar kjo me një heshtje mediatike, për t’i hapur rrugën më pas ndarjes nga Indonezia. Planet e tyre afatgjata dhe pasuritë e pafund të vëna në dispozicion për t’ia arritur qëllimit kanë krijuar një reagim të kundërt, ku populli

indonezian për ditë e më shumë po i kthehet Islamit dhe po vetëdijësohet për kurthet, ashtu sikurse thotë Allahu i Lartësuar në Kuran: **“Ata bënin plane, e Allahu i asgjësonte, se Allahu është më i miri që asgjëson** (dredhitë).”

Ishujt Moluke

Këtu mund të tërheqim një paralele mes përhapjes së Islamit dhe vullnetit të lirë e çiltërsisë së mësimeve të tij, dhe përhapjes së Krishterimit përmes kryqëzatave, gjenocidit dhe shfrytëzimit kolonialist. Në këtë ka argumente për ata që mendojnë!...

Ekonomia e Indonezisë:

Indonezia është shteti më i fuqishëm ekonomik në Azinë Juglindore dhe radhitet në vendin e gjashtëmbëdhjetë në botë, si dhe është anëtar i G-20-tës, shteteve me ekonomi të mëdha. Sektori i shërbimeve është sektori më i madh i ekonomisë dhe llogaritet aty diku rreth 45,3%. Ky sektor pasohet nga sektori i industrisë (40,7%) dhe i bujqësisë (14,0%). Megjithatë në bujqësi janë të punësuar më shumë njerëz, se sa në sektorët e tjerë, ku llogaritet të jenë të punësuar rreth 44,3% e 95 milion njerëzve që përbëjnë fuqinë punëtore.

Indonezia zotëron industri të mëdha përfshirë atë të naftës dhe gazit natyror, tekstilit, veshjeve dhe minierave. Produktet kryesore bujqësore përfshijnë vaj, palma, oriz, çaj, kafe, erëza, dhe gomë. Indonezia ka qenë vendi më i dëmtuar rëndë nga kriza financiare e Azisë Lindore e viteve 1997-98. Kundrejt dollarit amerikan rupia indoneziane pati rënë nga rreth 2.600 rupi për një dollar në një pikë shumë të ulët me afër 14.000, dhe ekonomia ra me 13,7%.

Mungesa e stabilitetit politik, reformat e ngadalta ekonomike dhe korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisë dhe biznesit e kanë ngadalësuar rikuperimin nga kriza. Edhe pse me hapa të ngadalta është duke u vërejtur një përmirësim, ku ekonomia e vendit ka shënuar një rritje me 5 % dhe papunësia është ulur deri në 8.46 % në vitin 2008. Kësaj i ka ndihmuar edhe fakti që krahasuar me fqinjët e saj Indonezia ka qenë më pak e prekur nga recesioni i fundit global. ■